



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i studimit me karakter profesional në
“Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh
publike”**

Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Barleti”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof As. Robert Çitozi

2. Dr. Vjollca Medja

Korrik/ 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT



Programi i studimit me karakter profesional në “Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh publike”, Universiteti “Barleti”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Barleti”
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportet (Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program me karakter profesional në "Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh publike"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 488, datë 27.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	S’ka (akreditohet për herë të parë)
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7 PAE/ 2 PAK
18	Numri i studentëve:	22 student total
19	Komente / të tjera:	

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 2

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës


Programi i studimit “Operator në fitness, palestër dhe organizim eventesh publike” është pjesë e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve, Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit në Universitetin “Barleti”.

Për herë të parë programi i studimit “Operator në fitness, palestër dhe organizim eventesh publike” hapi dyert për studentët në vitin akademik 2018-2019 ndërsa nga viti akademik 2019-2020 dhe në vijim, pas krijimit të njësisë bazë: Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve, është pjesë e këtij departamenti.

Qëllimi i hapjes së programit të studimit ishte fakti i përgatitjes së specialistëve në fushën e Edukimit Fizik dhe Sporteve në Shqipëri, me hapjen e programit të studimit “Operator në fitness, palestër dhe organizim eventesh publike”.

Universiteti “Barleti” kishte për qëllim krijimin e një departamenti multidisiplinar, aplikativ dhe inovator, ku janë të ndërthurura teoria dhe praktika me kërkimin shkencor dhe trajnimet e vazhdueshme për shërbimet në mësimdhënie, training dhe sektorët ndërlidhur me të. Filozofia e punës është “Studenti në qendër” që do të thotë se gjithçka që ndodh në departament, që nga proçesi mësimor, shërbimet, aktivitetet dhe mjetet janë në dispozicion eskuziv të studentit. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet një stafi dinamik të zgjedhur dhe të përkushtuar, një ambjenti të kompjuterizuar që mundëson kontakte të vazhdueshme me botën akademike perëndimore dhe nëpërmjet veprimtarive të larmishme ekstrakurrikulare.

Programi i studimit “Operator në fitness, palestër dhe organizim eventesh publike” synon pajisjen e studentëve me një formim akademik bazë të përqëndruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe të domosdoshme për t’i përdorur në karrierën profesionale në sektorin e sportit si dhe aftësimin për të përballuar kërkesat e tregut të punës në sektorin përkatës. Filozofia arsimore dalluese e këtij programi është se promovon dhe zbaton kombinimin në aspektin e dyfishtë të studimit akademik me mësimin e aplikuar në botën profesionale. Kompetencat specifike të programit lidhen me aftësimin për të aplikuar në qasje sistematike në kërkimin, hartimin, planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e një strategjie për Edukimin Fizik dhe Sportin në tërësi si dhe sugjerimin e zgjidhjeve në përputhje me rrethanat konkrete, etj.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Mbështetur në dokumentacionin që disponojmë, Universiteti "Barleti" ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit dy vjeçar profesional "Operator në fitness, palestër dhe organizim eventesh publike", nëpërmjet shërbimit në AMS.

Aplikimi zyrtar i IAL-së është dorëzuar në ASCAL më datë 22.10.2021: (Shkresë e IAL Nr.1123 prot, datë 21.10.2021, dërgon formularin e aplikimit - regjistruar ne protokollin e ASCAL Nr. 283 prot, datë 22.10.2021).

Nëpërmjet specialistëve të ASCAL ne si GVJ, jemi informuar në kohën e duhur mbi agjendën e fazës së vlerësimit për programin dy vjeçar profesional të studimit "Operator në fitness, palestër dhe organizim eventesh publike" (Universiteti "Barleti"). Gjithashtu në zyrat e ASCAL kemi zhvilluar trajnimin e duhur për procesin e vlerësimit të jashtëm të këtij programi studimi.

Kjo procedurë vlerësimi kulmoi me vizitën dy ditore në institucion në datat 07.04.2022 dhe 08.04.2022, ku sipas agjendës arritëm të ballafaqonim dokumentet shkresore me realitetet konkrete me të cilat u përballëm. Jemi të bindur që ky proces vlerësimi ka respektuar maksimalisht kornizën ligjore të akreditimit të programeve të studimit në IAL-të shqiptare.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve dhe për çdo kriter që i referohet standartit për programin dy vjeçar profesional të studimit "Operator në fitness, palestër dhe organizim eventesh publike". Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe kryhet një analizë SWOT mbi programin e studimit që akreditohet.

Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Aviola Bardhi.


Më datë 21/06/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 20/53 Prot., datë 21/06/2022, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, me shkresë zyrtare Nr. 854 Prot., datë 30.06.2022.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet ne raport final.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al

Faqe 4

Vlerësimi i programit të studimit me karakter profesional në “Operator në fitness, palestër dhe organizim eventesh publike” ofruar nga Universiteti “Barleti”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Në Statutin e Universitetit Barleti theksohet se ai ka për mision të përgatisë studentët si profesionistë novatorë, krijues e sipërmarrës të aftë për sfidat e së tashmes dhe të së ardhmes, si qytetarë të angazhuar të një botë në ndryshim dhe zhvillim të vazhdueshëm. Ai ka për qëllim të ofrojë studime universitare në cikletë ndryshme në përputhje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve EQF dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve KSHK, të bazuara në kërkim e inovacion si dhe të lidhura ngushtë me praktikën e aplokimit, për të përgatitur teknikë, specialist dhe ekspertë të mirëformuar.</p> <p>Në kuadrin e të mësuarit gjatë gjithë jetës, ai ka për qëllim të ofrojë programe studimi afatshkurtëra për kualifikime e specializime, si dhe për përditësimin e dijeve të fituara.</p> <p>GVJ konkludon se programet e studimeve në UniBa hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i IAL i Universitetit Barleti.</i></p> <p><i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të Institucionit 2020-2030.</i></p>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>GVJ konstatojnë se Statuti dhe rregullorja e UniBa i përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike, gjithashtu dhe program i studimit “Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh publike” është hartuar dhe ofruar në përputhje me dokumentat e sipërpërmendura.</p> <p>UniBa synon krijimin e një IAL-je cilësore si një aktor i zhvillimit, i cili ofron vlera të vërteta profesionalizmi dhe qytetarie. Ai synon të jetë një institucion inovativ dhe lider, aplikativ dhe praktik, i orientuar nga tregu i punës duke vendosur studentin në qendër.</p> <p>Programi i studimit synon pajisjen e studentëve me një formim akademik bazë të përqëndruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe të domosdoshme për t'i përgatitur në karrierën profesionale në sektorin e sportit si dhe aftësimin për të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


Faqe 5

	<p>përballuar kërkesat e tregut të punës në këtë sektor.</p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i IAL i Universitetit Barleti.</i></p> <p><i>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit.</i></p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Universitetit Barleti.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.</p>	<p>Në Urdhërin e hapjes së këtij programi studimi të MASR me Nr. 488, datë. 27.07.2018 theksohet që ky programi studimi është profesional, realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra) dhe në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë Profesionale” referuar nilelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. UniBa ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas sistemit europian të transferimit dhe grumbullimit të krediteve (ECTS).</p> <p>Referuar dokumenteve bazë institucionale si Statuti, Plani i Zhvillimit Strategjik dhe Rregullorja e Fakultetit, GVJ del në konkluzionin se ky program studimi “Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh publike” ofrohet në përputhje me fushat e drejtimit akademike të UniBa, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit.</i></p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Universitetit Barleti.</i></p> <p><i>Evidenca 6.a. Rregullore e Departamentit Edukim Fizik dhe Sporte.</i></p>
<p>Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p><u>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nuk na rezulton që kemi një studim të mirëfilltë mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këtë program profesional 2 vjeçar.</u> Ka nje dokument argumentimi të programeve profesionale në UniBa të hartuar nga Rektori ku theksohet: “Këto programe përbëjnë një zhvillim në kuadrin e objektivave afatmesme dhe afatgjata të UniBa. Ato synojnë zhvillime të rëndësishme në edukimin profesional. Institucioni nëpërmjet zhvillimit të programeve profesionale, synon të arrijë në ndërtimin e teknoparkeve për të nxitur sipërmarrjen në aplikimin e dijeve në formë ndërmarrje, shumimin e këtij aktiviteti në një kohë të shkurtër dhe dhënien mundësi studentëve të fillojnë veprimtari vetpunuese”.</p> <p>GVB pretendon se në vitin 2017 kur është bërë kërkesa për hapjen e programit të studimit nuk është kërkuar studim tregu.</p> <p><i>Evidenca 14.e. Argumentimi për hapjen e programeve profesionale dy-vjecare.</i></p> <p><i>Evidenca 14.g. Vendim Departamenti për hapjen e</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 6

	<i>programeve profesionale dy-vjecare.</i>			
Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.	GVJ nuk gjen në dokumentacionin e paraqitur studime periodike mbi tregun e punës nga pranimi dhe pas daljes në punë të studentëve të këtij programi studimi. Sigurisht që ka opinione dhe argumentime mbi nevojën e tregut për këta specialistë nga ana e Rektorit apo Përgjegjësit të Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sportit i cili mbulon këtë program studimi, por ato nuk janë të mjaftueshme për të krijuar një pasqyrë të saktë mbi kërkesat dhe dinamikat e tregut të punës. <i>Evidenca 14.e. Argumentimi për hapjen e programeve profesionale dy-vjecare.</i> <i>Evidenca 14.g. Vendim Departamenti për hapjen e programeve profesionale dy-vjecare.</i>			
Kriteri 6. Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	(Identik me kriterin 5) GVJ nuk gjen në dokumentacionin e paraqitur studime periodike mbi tregun e punës nga pranimi dhe pas daljes në punë të studentëve të këtij programi studimi. Sigurisht që ka argumentime mbi nevojën e tregut për këta specialistë nga ana e Rektorit apo Përgjegjësit të Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sportit i cili mbulon këtë program studimi, por ato nuk janë të mjaftueshme për të krijuar një pasqyrë të saktë mbi kërkesat dhe dinamikat e tregut të punës. <i>Evidenca 14.e. Argumentimi për hapjen e programeve profesionale dy-vjecare.</i> <i>Evidenca 14.g. Vendim Departamenti për hapjen e programeve profesionale dy-vjecare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së	GVJ konstaton se për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, Fakulteti i Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit dhe Departamenti Edukim Fizik dhe Sporte kanë të ndërtuar një sistem funksional të brendshëm i cili siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda dhe jashtë institucionit, si me: - Rektoratin, - Fakultetin,

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al


Tel:+355 (04) 222-43423

<p>tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Dekanin e Studenteve, - Ndërveprim me departamente të tjera si Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit, - Zyrën e Pranimit dhe Rregjistrimit të Studentëve, - Zyrën Alumni etj <p>Ndarja e detyrave ndërmjet strukturave akademike, ndihmës akademike dhe atyre administrative, siguron një ofertë akademike cilësore dhe konkurruese në treg, proces mësimor korrekt, aktivitete jashtë kurrikule, praktika mësimore, shërbimet e tjera studentore etj.</p> <p>Detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara qartë në Statut dhe Rregulloret përkatëse institucionale.</p> <p>Evidenca nr.2: Statuti i Universitetit “Barleti”.</p> <p>Evidenca nr. 5 Rregullorja UniBa.</p> <p>Evidenca 6.a: Rregullorja e Fakultetit.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Konstatojmë që UniBa ka një numër të madh marrëveshesh me institucione homologe si brenda ashtu edhe jashtë vendit duke ndjekur një politikë hapje institucionale për shkëmbime eksperiencash, programesh e stafesh akademike. Ai e ka përcaktuar këtë politikë bashkëpunimi me partnerë vendas dhe të huaj në dobi të përmbushjes së objektivave të programeve të studimit që ofron.</p> <p>Për programin profesional studimit “Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh publike”, institucionet me të cilat bashkëpunon ngushtësisht edhe për garantimin e praktikave mësimore për studentët e këtij programi studimi janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Spitali i Traumës Tiranë 2. Spitali Salus 3. QSUT 4. Spitali Geraldina 5. Green Garden 6. Aquadrom 7. Palestra Praktica <p>UniBa ka nënshkruar marrëveshje me IAL ndërkombëtare që janë: Šiauliai University, Lithuania; University of Valladolid; Universidad De Córdoba, Spain; Universidade Nova De Lisboa; University of South Bohemia, Czech Republic; University of Szczecin, Poland; Kodolanyi Janos University, Budapest, Hungary etj.</p> <p><u>Vetë Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve duhet të bëjë më shumë në drejtim të nënshkrimit të marrëveshjeve me IAL të huaja të cilat ofrojnë programe studimi të njëjta apo të ngjashme e cila do të mundësonte funksionimin e shkëmbimit të eksperiencave për studentët dhe</u></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al


Faqe 8

	<p><u>stafet akademike.</u> GVJ konstaton që për momentin nuk kemi marrëveshje të tilla aktive ndaj ato duhet të shikohen si prioritete në të ardhmen e afërt.</p> <p><i>Evidence 32. Tabele me institucionet bashkëpunuese për praktikën mësimore.</i></p> <p><i>Evidenca .34 Teniss-Tirana.</i></p> <p><i>Evidenca 34 Aquadromi.</i></p> <p><i>Evidenca. 34 Eqerem Cabej.</i></p> <p><i>Evidenca. 34 Spitali Traumes.</i></p> <p><i>Evidenca.34 Gren Garden.</i></p> <p><i>Evidenca.34 Palestra-Praktica.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve me qëllim mbarëvajtjen e procesit të arsimit cilësor të programit të studimit “Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh publike” duke patur një numër të konsiderueshëm studentësh tek programet e mësuesisë ka edhe një numër jo të vogël marrëveshjesh bashkëpunimi të cilat shfrytëzohen edhe për këtë program studimi.</p> <p>Për të bërë të matshëm efikasitetin e këtyre bashkëpunimeve konstatojmë nga dokumentacioni i paraqitur se njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 35. Raport i fundit periodik analitik i perfitimit nga marreveshjet e bashkepunimit ne funksion te realizimit te programit.</i></p> <p><i>Evidenca 38. Analizë e Departamentit përgjegjës për arritjen e objektivave formuese të programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Dokumentacioni i paraqitur na jep një paqyrë të qartë se institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ai ofron.</p> <p>Bazuar në modalitetet e përcaktuara në marrëveshjet e bashkëpunimit apo në marrëdhëniet me institucionet ku studentët kryejnë praktikën, procedurat e zhvillimit të praktikave profesionale janë të rregulluara edhe nëpërmjet akteve të brendshme, në të cilat janë parashikuar si procedurat që duhet të ndiqen ashtu edhe roli i aktorëve dhe njërive të ndryshme të përfshira në këtë proces.</p> <p><i>Evidenca 6.a. Rregullore e Departamenti Edukim Fizik dhe Sport.</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al

Faqe 9

	Evidenca 14.II. Analize PUNE DEFS 20-21.			
Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	<p>Në Planin Strategjik të Zhvillimit të këtij programi theksohet se: Ky program synon pajisjen e studentëve me një formim akademik bazë të përqëndruar në njohuritë dhe kompetencat kyce të domosdoshme për ti përdorur në karrierën profesionale në sektorin e sportit si dhe aftësimin për të përballur kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Meqënëse filozofia arsimore dalluese e këtij programi është promovimi dhe zbatimi i kombinimit të studimit akademik me mësimin e aplikuar në botën profesionale, studentet e programit profesional dy vjeçar “Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh publike” në përfundim të studimeve kanë hapësire ligjore për ofrimin e tranimeve profesionale. Në këtë aspekt UniBa ofron mundësi trajnimi për studentët referuar bashkëpunimit me federata të ndryshme sportive në vend apo animatore në vend.</p> <p>Evidenca 29. Te dhena tabelore permblledhese per punesimin e studenteve.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/ module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit “Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh publike” është i strukturuar në 2 vite shkollorë dhe 4 semestra të rregullt. Zhvillohen gjithsej 14 lëndë të ndara në module sipas 2 viteve shkollorë). Në 14 lëndët që parashikohen në planin mësimor përfshihen praktikat por <u>nuk gjejmë provimin final</u>. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 41 datë 24.1.2018, e ndryshuar) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E).</p> <p>A - duhen 15-20% <u>Nuk ka asnjë lëndë apo modul !!</u></p> <p>B – duhen 45-55% janë faktike 72 ECTS ose 60%</p> <p>C - duhen 5-15% janë faktike 12 ECTS ose 10% ✓</p> <p>D - duhen 10-15% janë faktike 36 ECTS ose 30%</p> <p>E - duhen 3-5% <u>Nuk ka detyrim përmbyllës. !!</u></p> <p>Duke iu referuar kurrikulës programit të studimit dhe rregullores vërehet që programi i studimit “Operator në fitness, palestër dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


Faqe 10

	<p>organizime eventesh publike” është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, por ka nevojë të ripunohet që të jetë plotësisht në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Një semestër i rregullt përmban 30 ECTS.</p> <p>Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit. <u>Konstatojmë që programi i studimit nuk ka të përcaktuara seminare në përmbajtjen e tij!</u> Në përfundim të studimeve të tyre studentët e këtij programi grumbullojnë 120 ECTS.</p> <p>Evidenca 14.b. Kurrikula, programi i studimit.</p> <p>Evidenca 63. Plani Mesimor OP. në Fitnes.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfundimin e njohurive gjithëpërfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Në planin strategjik të programit të studimit theksohet që programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfundimin e njohurive gjithëpërfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p> <p>Në kompetencat specifike përmendim: aftësinë për të aplikuar si teknik i lartë një qasje sistematike në hartimin, planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e një strategjie të edukimit fizik, sportit dhe aktiviteteve rekreative dhe eventeve.</p> <p>Në RVB theksohet: Në përfundim të studimeve studenti krijon një profil profesional e kulturor: - me një gamë të plotë aftësish njohëse dhe praktike që nevojiten për të gjetur zgjidhje krijuese për probleme në lidhje me fushën e fitnesit, palestrës, si dhe organizimit të ngjarjeve publike; - për kryerjen e aktiviteteve komplekse me vegla pune, aparatura, apo pajisje të tjera; - për demonstrimin e aftësive për planifikim, organizim dhe kontrollin e veprimtarive të punës; - me aftësi për kontroll dhe mbështetje për personelin, duke siguruar shpjegime ose udhëzues për të realizuar një veprimtari specifike.</p> <p>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit.</p> <p>Evidenca 2. Tabela përmbledhese Operator në “Fitnes, Palestër dhe organizime eventesh publike”.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional</p>	<p>Në planin strategjik të programit të studimit shikohet qartë që programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p> <p>Tek pjesa – Aftësimi profesional thuhet se: Programi synon</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


Faqe 11

<p>praktik.</p>	<p>pajisjen e studentëve me kompetencat e nevojshme për të qënë të aftë të përballojnë kërkesat e tregut të punës në sektorët përkatës. Në përfundim të programit të studimit ai duhet të zotërojë aftësi e kompetenca të tilla si: - Kapacitetin për analizë e sintezë; - Për të zbatuar njohuritë në praktikë; - Për tu përshtatur në situatat e reja; - Aftësi të menaxhimit të informacionit nga burime të ndryshme; Aftësi të përshtatjes me punën në grup dhe atë individuale.</p> <p>Studentët në mbarim të këtij programi studimi janë të fokusuar në fushën e fitnesit e cila ka një gamë shumë të madhe specialitetesh si dhe tek animacioni ose organizimi i eventeve publike pse jo edhe ato private.</p> <p>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>GVJ konstaton se ky program studimi në themel të tij ka zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme. Në Planin Strategjik për zhvillimin e programit të studimit theksohet se ai synon: - Të pajisë studentët me një formim akademik bazë të përqëndruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe të domosdoshme për t'i përdorur në karrierën profesionale. – Të integrojë mësimdhënien, kërkimin dhe shërbimet në mënyrë të tillë që të pasurojë përvojën e të nxënit.</p> <p>– Filozofia dalluese është se ky program promovon dhe zbaton kombinimin në aspekt të dyfishtë të studimit akademik me mësimin praktik në botën profesionale.</p> <p>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni/ njësia kryesore/ kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>UniBa me dokumentacionin e paraqitur na dëshmon se në tërësinë e tij ai ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e këtij programi studimi në atë fushë. Nga viti në vit pasqyrat dhe tabelat e paraqitura evidentojnë rritjen cilësore në grada e tituj të stafit akademik të brendshëm-me kohë të plotë dhe të jashtëm-me kohë të pjesshme.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit ka në përbërje staf si vijon:</p> <p>Viti akademik 2020-2021: 38 PAE/ 30 PAK</p> <p>Viti akademik 2019-2020: 33 PAE/ 37 PAK</p> <p>Viti akademik 2018-2019: 28 PAE/ 28 PAK</p> <p>Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporte:</p> <p><u>Viti akademik 2020-2021:</u> 14 PAE (2 Prof, 1 Prof as, 1 Dr, 10 Msc)/ 9 PAK (1 Prof as , 1 Dr, 7 Msc)</p> <p><u>Viti akademik 2019-2020:</u> 14 PAE (1 Prof, 2 Prof as , 1 Dr, 10 Msc)/ 2 PAK (1 Prof as, 1 Dr)</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al

Faqe 12

	<p><u>Viti akademik 2018-2019</u>: 10 PAE (2 Prof, 2 Prof as, 1 Dr, 5 Msc)/ 5 PAK (1 Prof, 4 Msc).</p> <p>Nga shqyrtimi i programit, vërehet një përshkrim i qartë i objektivave formues të programit të studimit, duke mundësuar si output për studentët fitimin e kompetencave (të përgjithshme, specifike dhe të transferueshme) në përfundim të programit “Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh publike”</p> <p>Evidenca 2. Tabela përmbledhëse “Operator në Fitnes, Palestër dhe organizime eventesh publike”.</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacionin dhe evidencat e paraqitura nga IAL del në konkluzionin se ky program studimi ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p> <p>Në Planin Strategjik thuhet se studentët e këtij programi nuk mund të jenë periferikë-rajonalë. Ata kanë si objektiv që të dijnë të konkurojnë në tregun e punës jo vetëm në Shqipëri. Në planet zhvillimore të UniBa rritja e numrit të studentëve në këto programe profesionale 2 vjeçare do të kërkojë burime të reja dhe plane me të sofistikuar mbështetëse sidomos në investime thelbësore në infrastrukturën sportive, të fitnesit dhe evente animacionit.</p> <p>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 13


II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.</p>	<p>Në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 është e përcaktuar qartë domethënia e programeve profesionale “Institucionet e arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studimi me karakter profesional, pas arsimit të mesëm, me 60 ose 120 kredite formimi, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Kohëzgjatja e tyre normale është një ose dy vite akademike dhe në përfundim lëshohet respektivisht “Certifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimit të kryer. Kreditet e grumbulluara gjatë studimeve profesionale të larta mund të transferohen në studimet e ciklit të parë, që referohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas kritereve të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë.</p> <p>GVJ gjatë shqyrtimit të syllabuseve të lëndëve del në konkluzionin se ato përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen etj,</p> <p>Fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe janë bizneset që operojnë në fushën e fitnesit dhe përkujdesjes shëndetësore, pranë ndërmarrjeve dhe institucioneve të ndryshme që operojnë struktura fitnesi, palestra apo merren me organizime eventesh si brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>Evidenca 14.c. Vendim Senati për hapjen e programeve profesionale dy-vjeçare.</i></p> <p><i>Evidenca 14.d. Kërkesa për hapjen dhe organizimin e programeve profesionale dy-vjeçare.</i></p> <p><i>Evidenca 14.e. Argumentimi për hapjen e programeve profesionale dy-vjeçare.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e</p>	<p>Bazuar në legjisllacionin kombëtar në fuqi (VKM 41 datë 24.1.2018, e ndryshuar) lëndët në programin e studimit “Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh publike” duhet të ndaheshin në pesë kategori (A, B, C, D, E).</p> <p>A - duhen 15-20% <u>Nuk ka asnjë lëndë apo modul !!</u></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 14

<p>evropiane në fuqi.</p>	<p>B – duhen 45-55% janë faktike 72 ECTS ose 60%</p> <p>C - duhen 5-15% janë faktike 12 ECTS ose 10% ✓</p> <p>D - duhen 10-15% janë faktike 36 ECTS ose 30%</p> <p>E - duhen 3-5% <u>Nuk ka detyrim përmbyllës. !!</u></p> <p>Duke iu referuar kurrikulës programit të studimit dhe rregullores vërehet që programi i studimit “Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh publike” është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, por <u>ka nevojë të ripunohet që të jetë plotësisht në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Një semestër i rregullt përmban 30 ECTS dhe një vit akademik ka dy semestra dhe 60 ECTS.</u></p> <p><i>Evidenca 14.b. Kurrikula, programi i studimit.</i></p> <p><i>Evidenca 63. Plani Mesimor Operator. në Fitnes...</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>Programi i studimit “Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh publike” përmban planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, praktikat, labororet, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj. GVJ konstaton që në planin mësimor tek shpërndarja e ngarkesës në auditor <u>konstaton mungesën e seminareve.</u> Tek tipet e veprimtarive <u>mungojnë tipet A dhe E</u> mangësi të cilat duhet të korigjohen menjëherë pas këtij procesi akreditimi. Plus që <u>ka disa mospërputhje me përqindjen e shpërndarjes së këtyre tipeve të veprimtarive konform VKM 41 e ndryshuar.</u></p> <p><i>Evidenca 14.b. Kurrikula, programi i studimit.</i></p> <p><i>Evidenca 63. Plani Mesimor Operator. në Fitnes...</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>Programet e lëndëve përmbajnë informacionet e nevojshme për leksionet, ushtrimet, praktikat, apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara dhe me një cilësi të mirë.</p> <p>Syllabuset, për secilën lëndë, ofrojnë të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën brenda dhe jashtë auditorit, kreditet ECTS, përshkrimin e lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literaturë kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxënit të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit, metodat e vlerësimit të njohurive dhe llogaritjen e ECTS. Ato miratohen nga departamenti dhe janë të firmosura nga përgjegjësi i departamentit. Titullarët e lëndëve janë me grada e tituj.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423




Web site: www.ascal.al


Faqe 15

	<p>Mënyra e vlerësimit të dijeve tregohet në syllabet e lëndëve. Konkretisht, në përgjithësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 20 % provimi i ndërmjetëm - 10 % pjesëmarrja dhe aktivizimi - 20 % detyra e kursit - 50 % provimi përfundimtar <p>Për frekuentimin e studentëve IAL ka vendosur detyrim të paktën 50% të leksioneve dhe 75% të ushtrimeve, seminareve, praktikave.</p> <p>Konstatohet që në jo pak syllabe <u>ka nevojë për korigjime sidomos në drejtim të shpërndarjes korrekte të orëve, mosvendosjes korrekte të literaturës apo faqeve që i korespondojnë temës në librin e rekomanduar.</u></p> <p>Duhet parë me vëmendje përcaktimi i literaturës së detyrueshme që do ishte mirë të ishin në kategorine e botimeve më të fundit në shqip në kombinim me literaturën e huaj që hyn në kategorinë leading books.</p> <p>Evidenca 64-75. Syllabuset e lëndëve.</p>
<p>Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>GVJ konstaton se natyra e lëndëve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në kredite siguron integrim të aspekteve teorike të informacionit që jep një modul dhe aplikimeve të mundshme praktike dhe mundësojnë arritjen e objektivave formuese si dhe është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p> <p>Studentët e UniBa informohen dhe orientohen në lidhje me mundësinë e transferimit të programeve të studimeve ose të krediteve të fituara gjatë zhvillimit të tyre si dhe në lidhje me mundësitë e punësimit dhe dinamikat e ndryshimeve pozitive ose negative në tregun e punës.</p> <p>Për realizimin e këtij programi studimi dhe përmirësimin e vazhdueshëm të strukturës së tij janë shfrytëzuar eksperiencat vendase dhe të huaja për rritjen e mundësive të punësimit pas përfundimit të studimeve apo vazhdimin e ciklit të parë të studimeve ku njohja apo transferimi i krediteve garantohej me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Evidenca 63. Plani Mesimor Operator. në Fitnes. Evidenca 64-75. Syllabuset e lëndëve.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>GVJ konstaton se mësimi praktik apo orëve praktike si ushtrime, laboratore apo praktika profesionale apo siç konsiderohen - elemente të punës konkrete në këtë program profesional studimi u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p> <p>Sipas RVB: Çdo modul ka përveç orëve teorike edhe ushtrime e laboratorë. Pjesë e pandarë e programeve profesionale janë trajnimet praktike që në total janë 4 (2 trajnime për vit të ndarë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 16

	në simestre me 60 orë secili).			
	<i>Evidenca 14.b. Kurrikula, programi i studimit.</i>			
	<i>Evidenca 63. Plani Mesimor Operator. në Fitnes.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2


Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Elementet e programit të studimit, emërtimi i lëndëve, struktura e vitit akademik, ndarja në orë e kredite është në përputhje me parashikimet ligjore të Nenit 70 të ligjit Nr. 80/2015 dhe të VKM nr. 41, datë 24.01.2018, të ndryshuar me VKM nr. 879 datë 18.12.2019. <i>Evidenca 3. Urdhëri i Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 488, datë 27/07/2018, për hapjen e Programit të Studimit “Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh publike” në Universitetin Marin Barleti. VKM nr. 41, datë 24.01.2018, të ndryshuar me VKM nr. 879 datë 18.12.2019.</i>
Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.	Mënyra e organizimit e të gjithë këtij programi studimi në semestra, shpërndarje të krediteve dhe moduleve përkatëse, mundëson objektivin e departamentit për të punësuar dhe rritur aftësitë e të nxënit të studentëve. Elementët e kërkuar janë standarte, të përfshira me kujdes në të gjithë elementët përkatës brenda tij. Në RVB theksohet: “Programi i studimit profesional i pajis studentët me njohuri teorike dhe praktike që në përfundim të studimeve të punësohen në përputhje me kualifikimin e fituar ose, të ushtrojnë profesionin e operatorit apo konsulentit në një nivel të duhur profesional”. <i>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit.</i> <i>Evidenca 14.b. Kurrikula, programi i studimit.</i>
Kriteri 3. Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/ lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha	Duke iu referuar planit mësimor të programit të studimit dhe rregullores vërehet që programi i studimit “Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh publike” është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite,

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


Faqe 17

<p>elementet e kërkuara.</p>	<p>por ka nevojë të ripunohet që të jetë plotësisht në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Një semestër i rregullt përmban 30 ECTS.</p> <p>Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit. <u>Konstatojmë që programi i studimit nuk ka të përcaktuara seminare në përmbajtjen e tij!</u></p> <p>Në jo pak syllabe ka nevojë për korrigjime sidomos në drejtim të shpërndarjes korrekte të orëve, mosvendosjes korrekte të literaturës apo faqeve që i korespondojnë temës në librin e rekomanduar.</p> <p>Evidenca 64-75. Syllabuset e lëndëve</p>
<p>Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p>GVJ konstaton që në planin mësimor të programit të studimit kemi një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike ato përbëjnë 30 ECTS ose 50% në vitin e parë po ashtu 30 ECTS ose 50% në vitin e dytë. Pra raporti teori praktikë është korrekt sipas rekomandimeve (50:50).</p> <p>Përsa i përket aftësimit në praktikë ose punë konkrete në profesion <u>kurrikula ka 24 ECTS ose 20% të programit të studimit me 120 ECTS ku standarti duhet të rreth 25%.</u></p> <p>Evidenca 63. Plani Mësimor Operator...në Fitnes...</p>
<p>Kriteri 5. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Në funksion të arritjes së objektivave strategjike, Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve vlerëson si parësore aftësimin profesional të studentëve në programin e studimit me karakter profesional “Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh publike” Departamenti nëpërmjet programit të studimit, synon të pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike që të zhvillojnë një perspektivë të integruar dhe harmonizuar mbi kuptimin, përmbajtjen dhe zhvillimin e industrisë së fitnesit dhe eventeve publike. Prioritetet në këtë drejtim përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -përditësimin dhe përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit, në përputhje me parashikimet ligjore, njohuritë në fushën e studimit dhe kërkesat e tregut të punës, bazuar në një proces të mirëpërcaktuar në aktet rregullatore të UniBa dhe kontaktet me tregun e punës; -vënien në zbatim të marreveshjeve të bashkëpunimit me kompani që operojnë në fushën e turizmit;

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 18



	<p>-realizimin e praktikave lëndore dhe profesionale në mënyrë të pavaruar me mbikqyrjen e një anëtari të stafit akademik dhe në rastin e intershipeve, të një përfaqësuesi të kompanisë.</p> <p><i>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit.</i></p> <p><i>Evidenca 14.b. Kurrikula, programi i studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3	
Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/ lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit është aktuale dhe i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat e tregut të punës. Plani mësimor është i qartë dhe në të janë të paraqitura lëndët/modulet me gjithë ngarkesën e tyre teorike apo praktike.</p> <p>Në planin mësimor ngarkesa mësimore është e përcaktuar qartë po ashtu edhe forma e mësimdhënies për çdo lëndë. Pothuajse të gjitha modulet që zhvillohen në këtë program studimi janë konceptuar me 6 ECTS me përjashtim të veprimtarive të kategorisë C dhe D që janë me 3 ECTS.</p> <p><i>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit.</i></p> <p><i>Evidenca 14.b. Kurrikula, programi i studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.</p>	<p>Nga analizat dhe shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Programi zgjat 2 (dy) vite / 4 (katër) semestra; • Në total 120 kredite në dy vite akademike, 60 Kredite/vit; • 7 lëndë + Praktike dhe zhvillim studenti – Viti 1 • 7 provime/ lëndë + praktika. • <u>Mungon Provim formimi (PPP) / Projekt profesional;</u> • Ngarkesa totale në auditor është: Viti I 600 orë, Viti II 600 orë, Gjithsej 1200 orë mësimore në auditor; • Format e mësimdhënies në planin mësimor janë: Teori, Ushtrime, Laboratore, Detyra, Praktike profesionale. <p>Gjykojmë që përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


Faqe 19

	<p>plotëson përgjithësisht kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit në tregun e punës.</p> <p>Evidenca 32. Tabelë me institucionet bashkëpunuese për praktikën mësimore.</p>
<p>Kriteri 3. Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p>	<p>Ky program mundëson përfitimin e aftësive të transferueshme, pasi i hap mundësi studentëve të punojnë në sektorë publikë dhe jo-publikë, si psh: në sektorin e fitnesit, rehabilitimit, aktivitetit fizik për shëndet, organizimin e eventeve publike nga pushteti lokal dhe ai qëndror etj. Pavarësisht përpjekjes për të ofruar një program cilësor i cili synon të mbajë një raport korrekt midis aktiviteteve të formimit teorik dhe atij praktik, nga takimi në institucion është dakortësuar se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <u>Është e nevojshme përfshirja e më shumë lëndëve/moduleve që lidhen dhe referohen direkt formimit të përgjithshëm në fitnes, palestra dhe evente.</u> - GVJ ka konsideruar, por edhe bërë me dije në takimet në institucion se: <u>marrja e njohurive, dhe rrjedhimisht e kompetencave të plota në fushat e mësipërme që formësojnë profesionalisht studentin është e pamjaftueshme vetëm me ofrimin e 2 apo 3 lëndëve të lidhura direkt me fitnesin dhe eventet.</u> <p>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit.</p> <p>Evidenca 14.b. Kurrikula, programi i studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përftimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.</p>	<p>GVJ gjykon se programi i studimit profesional dy vjeçar “Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh publike” ka për qëllim dhe synim dhënien e njohurive të konsoliduara profesionale dhe aftësive praktike në fushën e fitnesit, gym-it dhe organizimit të eventeve publike.</p> <p>Objektivat e programit në fjalë janë: - Të njohë studentët me njohuri themelore të fushës mjeksore sportive; - Të aftësojë studentët në Fitness dhe teknikat e stërvitjes. - Të zhvillojë tek studentët aftësinë e organizimit të aktiviteteve argëtuese sportive të kombinuara me performance animatore.</p> <p>Mendojmë se programi i studimit me modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/ punë konkrete mundëson përftimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës në tregun e punës.</p> <p>Evidenca nr.7. Rregullorja e programit</p> <p>Evidenca nr. 14.b Plani mësimor i programit</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423




Web site: www.ascal.al

Faqe 20

<p>Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/ përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Vihet re një bashkëpunim intensiv i institucionit me aktorët e rëndësishëm si qendrat e mëdha të finesit përmes të cilëve janë organizuar fizikisht por edhe online prej pandemisë seanca ndërveprimi me studentet. <u>Sugjerohet më shumë praktikë brenda lëndëve apo moduleve te vecanta.</u></p> <p>Psh brenda didaktikës së fitnesit duhet të ketë më shumë orë praktike. Në këtë mënyrë sigurohemi që studenti në këtë diplomë profesionale ka marrë më shumë njohuri praktike mbi dijet që ka përfituar brenda atij moduli. Aq me teper, kjo merr rëndësi në kushtet kur <u>numri total i lëndëve/ moduleve të lidhura direkt me fitness/evente është relativisht i ulët.</u></p> <p>Departamenti ka prioritete në bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar. Aktiviteti akademik i Departamentit mbështetet në vizionin e UniBa për ndërkombëtarizimin e institucionit. Në kuadër të këtij vizioni, dhe në funksion të arritjes së objektivave strategjike te programit te studimit, Departamenti vlerëson si prioritet rritjen dhe fuqizimin e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve konkrete. Ky prioritet krahas ndërkombëtarizimit, përfshin dhe drejtime të tjera të ndërlidhura si: punësimin e studenteve, ofrimin e shkëmbimeve studentore dhe të stafit akademik, përditësimin e kurrikulës së programit, mundësimin e projekteve studimore, botimeve akademike etj.</p> <p><i>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit.</i></p> <p><i>Evidence 32. Tabelë me institucionet bashkepunuese per praktiken mesimore.</i></p>
---	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423




Web site: www.ascal.al

Faqe 21

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikatat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>Institucioni ka një udhëzues të qartë të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies. Ky institucion ka ngritur struktura të posaçme të cilat monitorojnë mësimdhënien në auditor dhe jashtë tij. Proçesi mësimor monitorohet nga drejtuesi i njësisë bazë, dhe nga vetë IAL-ja. Pjesë e këtij vlerësimi janë edhe studentët. Rezultatet e vlerësimit bëhen publike.</p> <p>Për të nxitur metodat inovative të mësimdhënies “UniBa” organizon vazhdimisht trajnime të personelit akademik në bazë të fushës së studimit.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Universitetit Barleti.</i></p> <p><i>Evidenca 6.a. Rregullore e Departamenti Edukim Fizik dhe Sport.</i></p> <p><i>Evidenca 8. Rregullore e Njësisë së Kurrikulave dhe Cilësisë.</i></p> <p><i>Evidenca 11. Rregullore për vlerësimin dhe adminstrimin e performancës.</i></p>
<p>Kriteri 2. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>Format e mësimdhënies sipas Planit mësimor janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Teori (240 + 240) 480 orë mësimore në auditor. - SeminareNuk ka të parashikuara!!! - Ushtrimet (150 + 150) 300 orë mësimore në auditor. - Laboratore (90 + 90) 180 orë mësimore në auditor. - Praktika mesimore dhe profesionale (120 + 120) 240 orë në Auditor. - Provimi final.....Nuk ka të parashikuar!!! <p>Gjatë takimeve në institucion dhe bibliotekë konstatoam se një pjesë e literaturës për programin e studimit me karakter profesional nuk është ende gati, pasi profesorëve u duhet të punojnë për hartimin e tyre duke qënë se në dispozicion nuk ka literaturë të mjaftueshme për programet e studimit me karakter profesional. Literatura për këto programe studimi është më shumë në gjuhë të huaj dhe duke patur parasysh nivelin e mesatares së studentëve, profesorëve u nevojitet hartimi dhe përshtatja e leksioneve për këtë program studimi duke</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423




Web site: www.ascal.al



Faqe 22

	<p>thjeshtësuar përmbajtjen. Leksionet e programit të studimit miratohen në department.</p> <p>Çdo vit akademik departamenti miraton paraprakisht leksionet e hapura dhe aktivitetet që zhvillohen. Departamenti i organizon leksionet e hapura, në të cilat studentët marrin pjesë aktive dhe marrin informacion mbi tregun e punës dhe nevojat e tij. Studentët ndjekin praktikën në përputhje me rregulloren e praktikës dhe shlyejnë detyrimet e tyre të praktikës me qëllim që të fitojnë numrin e krediteve. Ndjekja e praktikave mësimore është një procedurë e cila është miratuar paraprakisht në departament.</p> <p>Evidenca 5 Rregullore akademike e "UniBa"; Evidenca 6 Rregullore e fakultetit FDSHSP; Evidenca 7 Rregullore e programit të studimit</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktivitetet formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Gjatë takimit me profesorët e programit të studimit, GVJ mori informacion mbi mënyrën e zhvillimit të leksioneve. Profesorët punojnë me qëllim përshtatjen e dijeve për interes të grupit ku ata japin mësim, si dhe përshtasin dijen e tyre me nevojat për njohuri të grupit.</p> <p>Stafi akademik i përfshirë në mësimdhënie është me eksperiencë dhe i specializuar në fushat ku ata japin leksion, gjë e cila i bën ata kompetentë në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Në UniBa nxitet përdorimi i teknologjisë si një instrument që përmirëson mësimdhënien dhe që pëlqehet nga studentët.</p> <p>Evidenca 5 Rregullore akademike e "UniBa"; Evidenca 6 Rregullore e fakultetit FDSHSP; Evidenca 7 Rregullore e programit të studimit</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Për qëllime të realizimit të orëve mësimore dhe të shpërndarjes së dijeve, pedagogët përdorin metoda interaktive dhe gjithëpërfshirëse. Lektorë të cilët kanë shoqëruar studentët në terren, vënë në dukje rëndësinë e praktikës dhe materializimin e njohurive.</p> <p>Në RVB theksohet: "Si rezultat i eksperiencave të pedagogëve në fushat e mjeksisë, shëndetit fizik, eventeve sportive dhe kualifikimeve përkatëse, ata kanë edhe përvojën disa vjeçare në mësimdhënie. Angazhimi i vazhdueshëm me zhvillimet më të fundit ndërkombëtare në mësimdhënie dhe të nxënë, stafi përdor në mënyrë efektive si metodat tradicionale dhe ato bashkëkohore të mësimdhënies online".</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020 janë angazhuar 10 staf nga të cilët: 8 PAE (1 Dr, 7 Msc) dhe 2 PAK (Msc)</p> <p>Për vitin akademik 2020- 2021 janë angazhuar 9 staf nga të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 23


	<p>cilët 7 PAE (Msc) dhe 2 PAK Msc. Programi mbulohet mbi 70% nga staf efektiv. Evidenca 2. Tabela përmbledhëse “Operator në Fitnes, Palestër dhe organizime eventesh publike”. Evidencat 20. CV-të e stafit akademik. Evidenca 37. Raportet vjetore te publikuara per monitorimin e cilesise.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion si dhe gjatë takimit me profesorët e programit të studimit, takimit me përgjegjës in departamenti apo NJSBC u vu re se institucioni nuk ka trajnime të mirëfillta në fushën e mësimdhënies, por për t’u ardhur në ndihmë pedagogëve të rinj, departamenti mundëson ndjekjen e leksioneve të dhëna nga stafi akademik më me përvojë në mësimdhënie.</p> <p>UniBa organizon takime dhe analiza periodike për reflektimin e ecurisë së ofertës akademike, ruajtjen e standarteve të mësimdhënies dhe promovuar bashkëpunimin e anëtareve të personelit akademik dhe përvojat më pozitive.</p> <p>Evidenca 40. Formular vlerësimi i studentëve për lëndën. Evidenca 41. Pyetësori i stafit akademik.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<p>Standardi III.2 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion, (Evidenca 42), dhe në vizitat në institucion, UniBa disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike.</p> <p>Infrastruktura është e përshtatshme dhe pajisur me salla leksioni dhe seminari, laboratore dhe bibliotekë. Gjatë vizitës në institucion, GVJ evidentoi se institucioni disponon, laboratorë, klasa, zyra, biblioteka, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e këtij program studimi. Referuar RVB, vizitës në institucion dhe të dhënave për infrastukturën, GVJ konstaton se institucioni disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimit e mësimimit të programit të studimit.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 24

<p>Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Evidenca 42. Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.</p> <p>Sistemet informative që janë në dispozicion në UniBa janë funksionale me një sistem menaxhimi të brendshëm të informacionit. Kjo bën të mundur që studenti të informohet nga pedagogu kudo që ndodhet dhe të ndërveprojë gjatë kursit online, si dhe të ketë akses në vlerësimet me pikë dhe nota.</p> <p>Studentët kanë akses në bibliotekën elektronike, ku studentet dhe stafi mund të shkarkojnë artikuj shkencor. Biblioteka ka një staf të gatshëm në ndihmë të studentëve e pedagogëve.</p> <p>Nga informacioni i paraqitur dhe konstatimet tona nga vizita në institucion, vlerësojmë se Universiteti Barleti ka infrastrukturë të konsoliduar për realizimin e programit mësimor. UniBa ka një sistem të brendshëm komunikimi me adresat e e-mail si për stafin akademik dhe studentët.</p> <p>Evidenca 39.b. Guide instruktive për mbështetjen dhe pasurimin e mësimdhënies on-line.</p> <p>Evidenca 46. Udhëzues për përdorimin strukturës së teknologjisë së informacionit.</p>
<p>Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Gjuha e programit të studimit është gjuha shqipe. Në syllabuset e lëndëve janë të vendosura literaturat sipas parimeve të ndërtimit të programit të lëndës, literaturë e detyrueshme dhe literaturë e rekomanduar. Vihet re se shumica e literaturave janë në gjuhë të huaj.</p> <p><u>Pra pothuajse mungon referenca në literaturë shqipe, ndërkohë që programi është në nivel diplome profesionale dhe ka nevojë për literaturë në shqip. Duke qënë se programi i studimit është me karakter profesional dhe studentët kanë një mesatare të ulët në hyrje stafit i ka lindur nevoja të sigurojë përkthime në shqip për lëndët e këtij programi studimi.</u></p> <p>Megjithatë, GVJ në takimin me pedagogët e programit, lidhur me literaturën e përdorur, mori informacion se ka materiale të përkthyer të vetë pedagogëve, të vendosura në dispozicion për studentët përmes platformës online.</p> <p>Biblioteka njofton departamentet përmes një njoftimi të dërgojnë listat me librat e lëndëve të programeve të studimit dhe periodikisht njoftohen po departamentet për pasurimin e literaturave të fundit të blera.</p> <p>Evidencat 20. CV-të e stafit akademik.</p> <p>Evidenca 45. Lista e teksteve, periodike ne Biblioteke</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423




Web site: www.ascal.al


Faqe 25

	<i>(hard-copy dhe e-book).</i>
<p>Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ofron për studentët mundësinë e aksesit në bibliotekën online. Universiteti “Barleti” ka anëtarësim të plotë në JSTOR, një bibliotekë e përbashkët digjitale e krijuar në 1995, që përfshin më shumë se 2000 revista akademike. JSTOR u themelua për të ndihmuar bibliotekat dhe botuesit akademikë të kalojnë aktivitetet e tyre nga printimi në operacione digjitale, për të zgjeruar aksesin e teksteve shkencore në të gjithë botën, si edhe për t’i ruajtur ato për brezat e ardhshëm.</p> <p>Çdo anëtar i stafit të Universitetit “Barleti” mund të hyjë në koleksionet e JSTOR duke u futur në http://ëëë.jstor.org/ dhe duke kërkuar për materiale.</p> <p>Drejtuesit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e artikujve të bibliotekës për të mbështetur programin, përfshirë buxhetin e planifikuar për të.</p> <p>Studentët apo stafi akademik, përmes llogarisë personale që ka secili, mund të hyjë në platformë, dhe vetëm me një buton mund të rezervojnë ose në mungesë mund të bëjnë kërkesë për rezervimin e librit sapo të kthehet në bibliotekë. Platforma është plotësisht e automatizuar dhe i gjithë ky proces ndiqet dhe menaxhohet lehtësisht nga stafi i bibliotekës përmes postës elektronike.</p> <p>UniBa ka marrëveshje bashkëpunimi edhe me disa biblioteka online siç janë EconBiz dhe Research4life, EBSCO, DOAJ etj.</p> <p><i>Evidenca 45. Lista e teksteve, periodike ne Biblioteke (hard-copy dhe e-book).</i></p>
<p>Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Institucioni zotëron një bazë laboratorike moderne dhe të pajisur shumë cilësisht. Laboratorët janë funksionalë dhe i shërbejnë më së miri procesit mësimor, si edhe studimeve specifike. Laboratorët shfrytëzohen nga studentët nën kontrollin dhe udhëheqjen e stafit përkatës akademik dhe ndihmës. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet/softëar e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor.</p> <p><i>Evidenca 42a. Raport i ekspertit për infrastrukturën.</i></p> <p><i>Evidenca 42b. Të dhëna për infrastrukturën.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Stafi akademik dhe studentët janë të pajisur me një adresë e-mail, e cila u ofron atyre mundësi komunikimi në internet, përmes veçorive të postës elektronike umb.edu.al me bazë në Google. Gjithashtu përdoren, gjatë procesit të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 26


	<p>mësimdhënies dhe mësimnxënies, Google Drive and sharing, Google Classroom etj.</p> <p>Me anë të sistemit të menaxhimit të mësimi SIS Classter, pedagogët inkurajohen të përdorin llogarinë e tyre të lëndëve individuale, të hapura nga zyra e IT.</p> <p>Nëpërmjet platformës LMS pedagogët ndajnë shënimet e leksioneve, studentët dorëzojnë projektet ose detyrat, kryejnë dhe aktivitete të tjera të ngjashme, të nevojshme për lëndën specifike.</p> <p>Evidenca 42a. Raport i ekspertit për infrastrukturën.</p> <p>Evidenca 42b. Të dhëna për infrastrukturën.</p> <p>Evidenca 46. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së TIK.</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.</p>	<p>Në statutin e Universitetit “Barleti” në Nenin 10 – Sigurimi i cilësisë thuhet se: Sigurimi i brendshëm i cilësisë është procesi i vazhdueshëm i monitorimit, vlerësimit, garantimit, ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë në UniBa. Sigurimi i cilësisë në UniBa realizohet nëpërmjet Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë (NJZHKC).</p> <p>NJZHKC përbëhet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> Drejtuesi i Njësisë Koordinatori për monitorimin dhe vlerësimin e procesit mësimor Koordinatori për procesin e vlerësimit të cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulave. Koordinatori për sigurimin e standarteve dhe ndjekjen e proceseve të akreditimit. <p>Ato vlerësojnë, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozojnë ndryshime për përmirësime të nevojshme.</p> <p>Evidenca 2. Statuti i Universitetit Barleti.</p> <p>Evidenca 8. Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së funksionimit të programit të studimit “Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh publike” vërehet që Departamenti i Edukimit Fizik</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423






<p>personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>dhe Sporteve është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programin studimor.</p> <p>Departamenti, me anë të nje programi vjetor aktivitetesh, workshop-esh dhe takimesh, synon rritjen e vetëdijes së stafit akademik dhe studentëve për cilësinë e programit të studimit. Specifikisht për studentët e rinj, departamenti organizon javën e orientimit në fillim të çdo viti akademik.</p> <p>Stafi akademik dhe studentët janë të vetëdijshëm që janë të përfshirë në një proces vlerësimi gjatë gjithë vitit akademik dhe posaçërisht për aspektet e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Evidenca 4. Plani Strategjik për zhvillimin e programit.</p> <p>Evidenca 6b. Rregullore e Departamentit EFS.</p> <p>Evidenca 7. Rregullore programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion nga takimi me stafin akademik të angazhuar në programin studimor, si dhe pas shqyrtimit të CV-ve të tyre, konstatohet që personeli akademik dhe ndihmës përfshihen në projekte shkencore, projekte profesionale, seminare/ workshop-e/ konferenca në fushat përkatëse të kërkimit shkencor etj.</p> <p><u>Shumë e rëndësishme nga ana e GVJ-së konsiderohet kualifikimi i stafit akademik MSc të cilët duhet të jenë në aktivë në studime shkencore, referime apo botime si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Fakulteti në bashkëpunim me departamentin duhet të mendojnë seriozisht për konferencën e tyre shkencore e cila mungon në kalendarin vjetor.</u></p> <p>Evidenca 43. Te dhëna te plota të aktiviteteve per kualifikimin dhe kerkimin shkencor te stafit akademik në 5 vitet e fundit.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit e tyre.</p>	<p>Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve - si njësia bazë për cilësinë e mësimdhënies, si dhe Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë (KPSSC)-si struktura kryesore në nivel institucional për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p> <p>Metodat kryesore përfshijnë përfitimin e njohurive përmes teksteve të lëndës, leksioneve ppt, prezantimeve individuale dhe në grup, projekteve kërkimore, leksioneve të hapura, praktika sportive, aplikime studimore, ndërveprimet me të ftuar nga fushat e fitnesit, eventeve, që vizitojnë kampusin, praktika profesionale, vizita në terren, aktivitete vullnetare, projekte dhe anëtarësime në klubet studentore dhe aktivitete të tjera jashtë shkollore.</p> <p>Evidenca 37. Raport vjetor i publikur për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 28



	<i>Evidenca 38. Analizë e Departamentit përgjegjës për arritjen e objektivave formuese të programit të studimit.</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	<p>GVJ u informua gjatë takimeve me stafin akademik të programit të studimit mbi aktivitete të ndryshme të zhvilluara, në të cilat personeli akademik dhe ndihmës trajnohet dhe teston metoda të reja mësimore.</p> <p>Këto trajnime realizohen kryesisht në kuadër të shkëmbimeve ndërkombëtare për trajnimin e stafit, apo aktiviteteve të mirëfillta trajnuese të organizuara nga Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së Universitetit dhe Departamenti.</p> <p>Aktivitetet trajnuese, objektivat, efektet dhe pritshmëritë analizohen dhe raportohen në strukturat përkatëse. Raportet janë të aksesueshme edhe në faqen e internetit.</p> <p><i>Evidenca 37.a Raport i vlerësimit të brendshëm të studenteve evidence.</i></p> <p><i>Evidenca 38. Analizë e Departamentit përgjegjës për arritjen e objektivave formuese të programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimmimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.	<p>Universiteti i pajis studentët me udhëzuesin e Studentëve, i cili informon studentët për të gjitha rregulloret, proceset, politikat dhe mekanizmat që udhëheqin studimet e tyre. Ky dokument është i publikuar edhe në faqen e zyrare të Universitetit. Rregullorja e institucionit/programit parashikon në mënyrë të qartë modalitetin e vlerësimit. Procesi i vlerësimit përfshin një shumatorë të vlerësimit të vazhdueshëm dhe atij përfundimtar. Pësia specifike e komponentëve të vlerësimit është specifike dhe ndryshon nga lenda në lëndë. Në përgjithësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 10 % ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive - 10 % plotësimi i detyrimeve (detyrave të kursit, essetë) - 30 % testimet gjatë vitit - 50 % provimi përfundimtar. <p>Rregullorja akademike, rregullorja e programit dhe silabusi i lëndës njoftohen për të gjithë studentët në fillim të çdo viti akademik dhe shpjegohen për çdo rast në varësi të kërkesave gjatë vitit akademik.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al



Faqe 29

	<p>Evidenca 5: Rregullore Universitetit Barleti; Evidenca 7: Rregullore e studimeve për programin Evidenca 14.3 Mënyra e vlerësimit të studentëve. Evidenca 63. Plani Mësimor OP. Në Fitnes.</p>
<p>Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Sipas shqyrtimit të syllabuseve të lëndëve në programin studimor, si dhe dhe takimit me studentët, njohuritë dhe aftësitë e studentëve vlerësohen përmes këtyre formave kryesore: 1) provim i ndërmjetëm, 2) prezantim 3) projekt 4) pjesëmarrje aktive.</p> <p><u>Në planin mësimor mungon detyrimi përmbyllës i cili duhet plotësuar dhe korrigjuar menjëherë pas akreditimit.</u></p> <p>Evidenca 5: Rregullore e Universitetit “Barleti”; Evidenca 7: Rregullore e studimeve për programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>Në javën e parë të semestrit akademik, pedagogu informon studentët mbi programin lëndor, i cili përmban informacion mbi: përmbajtjen e lëndës të organizuar në javë, objektivat e lëndës, rezultatet e të nxëniet të lëndës, literaturën bazë dhe të rekomanduar dhe materialet e tjera të lëndës, metodën e vlerësimit të lëndës, shpërndarjen e ngarkesës së bashku me afatet për secilin detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës.</p> <p>Përgjatë vizitës në institucion dhe gjatë intervistave me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi lehtësitë e marrjes së informacionit nga ana e studentëve.</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e studimeve për programin e studimit. Evidenca 63. Plani Mësimor OP. Në Fitnes.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimin, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Nga vizita në institucion konstatojmë që, në përgjithësi, provimet janë në formatin e provimeve të bazuara në letër, zhvillohen dhe vlerësohen në mënyrë anonime. Detyrat, projektet, dorëzohen në mënyrë elektronike dhe/ose të printuar tek pedagogu përkatës. Në të dy rastet, sekretaria hedh notat në rregjistrin përkatës elektronik.</p> <p>Studenti fiton të drejtën e dhënies së provimit të një lënde kur ka qenë i pranishëm në masën e detyrueshme në leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat sipas përcaktimit në Nenin 72 të Rregullores për funksionimin e Sekretarisë Mësimore.</p> <p>Gjatë periudhës së pandemisë institucioni ka përdorur platforma dhe sisteme online si google classroom ku janë përfshirë edhe module të vlerësimit elektronik. Në projektet për të ardhmen parashikohet të zgjerohet zbatimi i testimit online krahas proçeseve të tjera të mësimdhënies.</p> <p>Evidenca 9. Rregullore per Funksionimin e Sekretarisë Mesimore.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 30

	Evidenca 48. Politikat institucionale te publikimit te informacionit.			
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Pas shqyrtimit të rregulloreve dhe komunikimit me studentët gjatë programit të vizitave në institucion GVJ konstaton se studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimin e marrë dhe të marrë përgjigje sipas rregullave të përcaktuara. Në rastet kur pedagogu refuzon ndryshimin ose nuk kontaktohet dot, studenti bën një ankimim dhe ankesa i drejtohet përgjegjësit të departamentit i cili ngre një komision për shqyrtimin e ankesës. Pedagogu i modulit/ lëndës, duhet t'i sigurojë të gjitha dëshmitë për vlerësimin e studentit (testin, punimet etj). Vendimi i Komisionit të Rivlerësimit është përfundimtar dhe dokumentacioni bashkë me rezultatin dorëzohet e arkivohet në sekretarinë mësimore. Evidenca 9. Rregullore per Funkcionimin e Sekretarise Mesimore. Evidenca 63. Plani Mësimor OP. Në Fitnes.			
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.	Nga shqyrtimi i rregullores së programit të studimit si dhe nga vizita ne universitet u konstatua se studentët e ushtrojnë të drejtën e tyre për të kundërshtuar rezultatin e një vlerësimi duke paraqitur një ankese në sekretarinë mësimore në bashkëveprim edhe me Dekanen e studentëve me anë të një formulari të veçantë, brenda 3 ditëve pas shpalljes së notave përfundimtare por para shënimit të notës në Regjistrin e arritjeve akademike. Pedagogu i lëndës i shpall notat në mënyrë jo zyrtare para se t'i regjistrojë të njëjtat, me qëllim që t'u jepet mundësia studentëve për shpjegim lidhur me notat e vendosura. Evidenca 9. Rregullore per Funkcionimin e Sekretarise Mesimore. Evidenca 63. Plani Mësimor OP. Në Fitnes.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfundimin e njohurive, zhvillimin e	Përmbajtja e programit të studimit "Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh publike" i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al



Tel:+355 (04) 222-43423

<p>aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënësve për programet me karakter profesional.</p>	<p>njohurive është në përputhje edhe me nivelin e karakterit profesional të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e parë, për ata studentë që kanë rezultatet më të larta dhe kanë synime të qarta drejt cikleve më të larta të studimit. Krahas njohurive shkencore teorike, programi synon aftësimin praktik të studentëve nëpërmjet punëve të pavarura dhe praktikave. Përveç kurrikulës, studentët marrin pjesë rregullisht në aktivitete jashtë kurrikulare, siç janë forume të hapura, vizita në terren, konferenca studentore etj.</p> <p>Të gjitha lëndët zhvillohen sipas Tipologjisë I, në mënyrë interaktive leksione e seminare nga lektorë të kualifikuar e të specializuar në fushat perkatëse. Ngarkesa është e balancuar mes semestrave dhe lëndët ndjekin një radhë që është e nevojshme për përvetësimin e tyre. Në syllabuset e detajuara janë specifikuar kompetencat që fitojnë studentët në secilën lëndë të studimit.</p> <p>Evidenca 14.b. Kurrikula, programi i studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>30% e kurrikulës është e përbërë nga lëndë të tipit D, që garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p> <p>Programi përmban lëndë si: didaktika e fitnesit, traumatologjia dhe masazhi sportiv, etika në punë dhe komunikim, gjuhë e huaj anglisht apo gjermanisht, puna në grup dhe komunikimi që janë një bazë e mirë për interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p> <p>Evidenca 59,61. Syllabe gjuha angleze e gjermane.</p>
<p>Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>UniBa ka një traditë të mirë në krijimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me aktorët e biznesit. Në radhë të parë në këtë program studimi evidentohet se ka lindur si nevojë e bizneseve për burime njerëzore të kualifikuara, në fushën e fitnesit, palestrave apo organizimit të eventeve dhe me tej janë zhvilluar edhe takime me biznese të ndryshme përfshirë edhe ato në fushën e mirëqënies fizike dhe aktivitetit fizik për shëndet.</p> <p>Marreveshjet me biznesin e fitnesit mund të shërbejnë shumë mirë për të testuar njohuritë e marra përmes orëve të vizitave në biznes që duhet të ishin të parashikuara në cdo lëndë dhe jo vetëm duke u bazuar tek praktika mesimore.</p> <p>Shtirja e praktikës në 4 semestra bën të mundur ndërthurjen e formave të mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al



Faqe 32

	<p>Evidenca 14.b Plani mësimor i programit. Referencë: Paketa e praktikës</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Leksionet zhvillohen kryesisht duke kombinuar metodën tradicionale të shkrimit në tabelë me prezantime interaktive ppt. Këto shënime dhe përmbledhje leksionesh ndahen më studentët javë pas javë.</p> <p>Me përfundimin e lëndës pedagogu përgjegjës jep një pasqyrë të saktë mbi formatin mbi të cilën do të ndërtohet provimi përfundimtar. Studentët para këtij provimi kanë zhvilluar provimin e ndërmjetëm pra janë njohur me strukturën e provimit pasi provimi përmbyllës ka të njëjtën strukturë dhe format.</p> <p>Kjo mundëson që studentët janë të qartësuar me gjithshka ka lidhje me provimin përmbyllës të lëndës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - llojin dhe numrin e pyetjeve, - nivelet e vështirësisë së pyetjeve dhe - pjesët e programit që përfaqësojnë, - kohën e testit dhe - mënyrën e vlerësimit të përgjigjeve. <p>Evidenca 7: Rregullore e programit të studimit Kreu III/Neni 17. Evidenca 19: Programi lëndor i lëndëve (syllabuset)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 120 ECTS dhe mbrojtjen e diplomës, zyrat përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Zyra e Regjistrimit të Universitetit pajis studentët e diplomuar me diplomën dhe suplementin e diplomës profesionale sipas formateve të liçensuara dhe të aprovuara nga MAS.</p> <p>Evidenca 5. Rregullore e Universitetit Barleti. Evidenca 7. Rregullore programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.</p>	<p>Në RVB theksohet: Studentët e programeve profesionale <u>nuk i nënshtrohen provimit të formimit apo punim e mbrojtje diplome.</u> Megjithatë, studentët asistohen gjatë gjithë vitit si nga personeli akademik – titullarë të lëndëve përkatëse, nga pedagogu përgjegjës për trajnimet praktike, tutori i cili i ndjek në institucionin sportiv, shëndetësor apo spitalor ku zhvillohen praktikat si dhe nga koordinatori i departamentit ku programi i studimit bën pjesë dhe në veçanti nga koordinatori i programit profesional.</p> <p><u>GVJ lë rekomandim që në zbatim të VKM 41, e ndryshuar edhe programet profesionale të Kornizës së 5 të kualifikimeve përfundojnë me detyrim përmbyllës domosdoshmërisht.</u></p> <p>Evidenca 14.b Plani mësimor i programit. Evidenca 36. Vendim per emerimin e koordinorit te</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 33


	<i>programeve dy vjecare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 34


IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive nga ana e tyre</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e dokumenteve të dhënave të personelit akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ, të angazhuar në nivel institucioni është Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore [ZMBNJ].</p> <p>Për secilin person të angazhuar në UniBa, Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore mbledh dhe administron dokumentacionin sipas formateve të miratuara paraprakisht. Pranon dosjen me dokumenta të aplikantit, e selekton dhe ia përcjell departamentit përkates. Per krijimin dhe përditësimin e të dhënave, ZMBNJ bashkëpunon me njësitë bazë/kryesore, dhe njësitë e tjera, për të parë ecurinë e stafit gjatë një viti akademik për PAE/ PAK.</p> <p><i>Evidenca 11: Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;</i> <i>Evidenca 44: Formati Dosjes personale të stafit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka në fokusin e saj në hartimin e politikave, strategjive, për rekrutimin e një stafi të kualifikuar në përputhje me politikën e legjislacionin në fuqi, lidhur me punësimin.</p> <p>Stafi i Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve në programin e studimit: "Operator në Fitnes Palestra dhe Organizime Eventesh Publike" ka këtë raport të PAE me PAK ndër vite:</p> <p><u>Viti akademik 2020-2021:</u> 14 PAE (2 Prof, 1 Prof as, 1 Dr, 10 Msc)/ 9 PAK (1 Prof as , 1 Dr, 7 Msc)</p> <p><u>Viti akademik 2019-2020:</u> 14 PAE (1 Prof, 2 Prof as , 1 Dr, 10 Msc)/ 2 PAK (1 Prof as, 1 Dr)</p> <p><u>Viti akademik 2018-2019:</u> 10 PAE (2 Prof, 2 Prof as, 1 Dr, 5 Msc)/ 5 PAK (1 Prof, 4 Msc).</p> <p>Kjo pasqyrë flet për nivelin e stafit akademik për programin "Operator në Fitnes e Palestra dhe Organizime Eventesh publike", flet për raportin e stafit, ku mbi 70% e programit</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


Faqe 35

	<p>mbulohet nga PAE dhe pjesa tjetër nga PAK.</p> <p><u>Departamenti duhet të përcaktojë afate kohore për ecurinë e pedagogëve që janë me Master Shkencor, për të mos krijuar gap midis stafit në largim dhe atij që rekrutohet. Ngarkesat e pedagogëve janë të pasqyruara saktë në tabela.</u></p> <p><i>Evidenca 52 ose 24,25 Te dhena tabelore per stafin.</i></p> <p><i>Evidenca 11: Manuali i Menaxhimit te Burimeve Njerezore</i></p> <p><i>Evidenca 53: Ligji Nr. 80/2015, date 22.07.2015 Per arsimin e larte dhe kerkimin shkencor ne institucionet e arsimit te larte ne Republiken e Shqiperise</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Institucioni harton procedura me kritere të përgjithshme e specifike, si pjesë e akteve të brendshme rregullatore, të cilat bëhen publike në institucion dhe mund të aksesohen nga personat e interesuar dhe në faqen zyrtare të UniBa. <u>Procedurat specifike i harton njësia bazë, por dokumenti i kriterëve të përzgjedhjes nuk është paraqitur.</u></p> <p>Departamenti në bashkëpunim me institucionin merr masa për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale në të gjitha ambjentet e saj.</p> <p><i>Evidenca 11: Manuali i Menaxhimit te Burimeve Njerezore</i></p> <p><i>Evidenca 47. Te dhena nga faqja zyrtare web e UniBa, Zyra e Menaxhimit te Burimeve Njerezore</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Gjatë takimit me GVB, Përgjigjesin e Departamentit, por dhe me stafin akademik, rezultoi se kualifikimi i vazhdueshëm i stafit që mbulon këtë program studimi, ka nevojë që të kthehet në një prioritet për institucionin ku institucioni vetë duhet të mundësojë çdo facilitet, mobilitet në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitetet homologe brenda vendit, por përpjekje duhen bërë edhe për marrëveshje e mobilitete me IAL jashtë vendit. Institucioni mundëson mbështetje financiare për pjesëmarrje në Konferenca Shkencore brenda dhe jashtë vendit, projekteve shkencore e çdo veprimtari tjetër kërkimore shkencore sipas procedurave të përcaktuara paraprakisht dhe buxhetit të tij. Përsa më sipër, GVJ konstaton se mbështetja institucionale për kualifikime të vazhdueshme të personelit akademik nuk mungon, <u>por vetë personeli duhet të bëjë më shumë përpjekje për të kapur afatet ligjore të kualifikimeve.</u></p> <p><i>Evidenca 2. Statuti i IAL i Universitetit Barleti.</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 36



	<i>Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të Institucionit 2020-2030.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UniBa disponon dy kampuse në 3 ndërtesa. Kampusi 1 ndodhet në Rugën e Kosovarëve dhe shtrihet në një sipërfaqe totale prej 3,805 m² dhe me sipërfaqe të shfrytëzueshme 2,347 m², ndërsa Kampusi 2 ndodhet në Rugën “Frang Bardhi” dhe shtrihet në një sipërfaqe totale prej 2,933 m² dhe me sipërfaqe të shfrytëzueshme 6,451m². Hapësirat janë të ndara në klasa leksioni/seminari, laboratore, zyra për stafin, biblioteka me disa amjente, mjedise sportive si palestër sallë fitnesi, sallë mundje dhe boksi.</p> <p>Kapacitetet infrastrukturore në funksion të zhvillimit të veprimtarisë akademike, janë të përshtatshme dhe sipas parametrave bashkëkohore. Në universitet ka dhe ambjente të tjera ndihmëse dhe rekreative për stafin dhe studentët.</p> <p><i>Evidenca 42, 42a, 42b: Të dhëna të plota për infrastrukturën.</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset mësimore janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, të cilat garantojnë realizimin e procesit mesimor. Një nga objektivat kryesore strategjike të UniBa-s është digjitalizimi. Në kampusin e ri të Universitetit "Barleti", të gjitha auditorët janë të pajisur me smartboard dhe sisteme projektimi digjital, përfshirë të gjitha mjetet e tjera të nevojshme audio dhe video, të cilat janë në fazën e prokurimit. Në funksion të digjitalizimit i gjithë kampusi do të mbeshtetet edhe me rrjetet wifi dhe janë në proces vendosja e pajisjeve të nevojshme elektronike si PC, printera, skaner etj në zyrat e stafit akademik dhe atij administrativ.</p> <p><i>Evidenca 42: Të dhëna të plota për infrastrukturën.</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional,</p>	<p>UniBa për lëndët dhe programet e IT ka infrastrukturë të përshtatshme teknologjike ku janë instaluar sisteme operative si Windows XP; Software: MySql, Java. Bluel, Microsoft</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 37

<p>përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Visual Studio, SPSS, XAMPP, AutoCad, PhotoShop, Revit. Janë krijuar të gjitha ambientet e laboratorit të Informatikës, ambiente për ofrimin e kurseve të efikasitetit të energjisë. Janë vënë në dispozicion dhe ambientet sportive të plotësuara me aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formuese të programit të studimit në tërësi. Baza materiale duhet të pasurohet për çdo vit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>UniBa ka aktualisht dy laboratore të teknologjisë së informacionit, të cilët janë të pajisur me programe profesionale.</p> <p>Krahas lëndës së teknologjisë së informacionit studentët bëjnë lëndën e kërkimit sasior në laborator ku janë të instaluar programet e nevojshme, si Excel dhe SPSS.</p> <p>Ndërkohë, të gjitha klasat janë të pajisura me projektor, kompjuter / laptop dhe internet me lidhje fikse dhe wifi. Edhe palestrat janë të pajisura me mjetet e domosdoshme për programin specifik për lëndët praktike.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.</p>	<p>Kapacitetet infrastrukturore të UniBa-s janë të përshtatshme bashkohore dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Përveç kapaciteteve të tij, UniBa ka nënshkruar marrëveshje me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për numrin e studentëve si Pishinat në kompleksin “Green Garden”, kalçeto, me Shoqatën tenis Tirana, Palestra e Fitnesit (Praktika) Spitali i traumës, me universitete të ndryshme, me shkollat e mesme, me kampin e Skive Dardhë të Korçës, me Drejtorinë e Muzeve, me Shoqatën e Sportit Universitar etj.</p> <p><i>Evidenca 42: Të dhëna të plota për infrastrukturën.</i></p> <p><i>Evidenca 32: Marrëveshjet e bashkëpunimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij


Kriteret

Vlerësimi

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423





<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka e Universitetit "Barleti" është e konceptuar dhe e implementuar në hapësira të ndryshme të universitetit me qëllim shërbimin dhe ofrimin e librit sa më pranë studentit. Biblioteka është e ndarë në dy kampuse, përkatësisht në Kampusin 1 dhe në Kampusin 2. Në Kampusin 2 njësia qendrore e bibliotekës ndodhet në Katin e 1-rë me një hapësirë 27.3 m² dhe me 18 poste leximi. Nga kjo njësi bazë biblioteka zgjerohet po brenda Kampusit 2 në një tjetër hapësirë prej 95.1 m² ku janë të arkivuara revistat shkencore, punimet e konferencave, periodikët e fushave të ndryshme, 50 poste leximi dhe poste me kompjutera për ofrimin dhe aksesimin në bibliotekën dixhitale të universitetit dhe të bibliotekave online ndërkombëtare. Me tej, biblioteka zgjerohet në Kampusin e ri në katin underground me një hapësirë 70 m² dhe me 28 poste leximi si dhe poste me kompjutera për aksesimin në bibliotekat dixhitale. Po ashtu, biblioteka ka njësinë e saj edhe në Kampusin 1 përkatësisht, në godinën A me një hapësirë 40 m² dhe me 18 poste leximi. Në Kampusin e ri në godinën 6 katëshe ndodhet biblioteka e librit artistik. Biblioteka me të gjitha ambientet e saj është bashkëkohore.</p> <p>Evidenca 42: Të dhëna të plota për infrastrukturën.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Njësia qendrore e bibliotekës ka dhe shërben për arkivimin e një kopje të çdo libri fizik që ka biblioteka (dhe të çdo libri të ri që hyn në bibliotekë), arkivimin e dokumentacionit të bibliotekës, arkivimin e punimeve të diplomave të studentëve, si dhe vend-adresimi i stafit apo studentëve për çdo nevojë apo problematikë që lidhet me bibliotekën. Totali i titujve në bibliotekën e universitetit është 5.250 tituj. Institucioni kërkon në treg tituj nga Libri Universitar, Shtëpitë botuese përkatëse dhurimet nga vetë autorët dhe nga libraritë e ndryshme të qytetit. Ndërkohë, studentët e programit të studimit "Operator në Fitnes Palestra dhe Organizime Eventesh Publike" kanë mundësi të shfrytëzojnë një numër prej 60 tekste në bibliotekën fizike të UniBa, dhe me shumë tituj në aksesin që kanë në bibliotekën online. Librat e programit disponohen 3 deri në 5 kopje. Janë në gjuhën shqipe. Ndërsa revistat janë në numër më të madh. Mbetet vetëm që studentët ti frekuentojnë më shpesh ambientet e saj.</p> <p>Evidenca 45, 42c: Lista e teksteve periodikeve në Bibliotekë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit</p>	<p>UniBa i krijon kushtet studentëve për të aksesuar në mënyrë të barabartë e pa pagesë, në një sërë bibliotekash online. Si në EconBiz, bibliotekë që ofron orientim dhe ndihmë në kërkimin e artikujve, punimeve dhe librave dixhitalë si dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


Faqe 39

<p>dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>akses të plotë dhe të licensuar në internet për materialet që ofron universiteti "Barleti" duke patur marrëveshje bashkëpunimi. Në bibliotekën dixhitale JSTOR, e cila siguron qasje në më shumë se 12 milion artikuj të revistave akademike, libra, dhe burime kryesore në 75 disiplina. Universiteti ka abonim me account-in e bibliotekës nëpërmjet të cilit mund të aksesojë stafi dhe studentet dhe ku bëhet I mundur leximi online dhe ruajtja e materialeve që dëshirojnë direkt nga platforma e tyre. Të tjera burime janë, Open Dissertations.org (Ebsco Open Dissertation) që është një bashkëpunim midis Ebsco dhe BiblioLabs që është inovative për zhvillimin e kërkimit të disertacioneve doktorale ku janë të përfshirë të dhëna për disertacione dhe teza nga viti 1955 deri më sot, si dhe DOAJ (Directory of Open Access Journals) që është bazë e pavarur e të dhënave që përmban mbi 16 500 revista, ku mbulojnë të gjitha fushat e shkencës.</p> <p>Evidenca 42d: Të dhëna të plota për platformat online të Bibliotekës.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirje të aktorëve të brendshëm dhe jashtëm të interesuar për realizimin e programit, sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit. Në komisionin e sigurimit të brendshëm të cilësisë ka një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve. Përbërja e komisionit të sigurimit të cilësisë është e tillë që garanton përfaqësim të plotë të të gjitha njësive akademike dhe administrative. Në nenin 4 të rregullores së komisionit të brendshëm të sigurimit të cilësisë përcaktohet se 4 prej anëtarëve janë përfaqësues të personelit akademik, administrativ duke krijuar kështu mundësinë edhe për pedagogët me kohë të pjesshme. Ekspertët e jashtëm janë bashkëpunëtorët më të ngushtë të njësive bazë që janë edhe njësitë përgjegjëse për ofrimin e programeve të studimit në përputhje me standardet dhe kriteret e cilësisë.</p> <p>Nga mënyra e organizimit të shërbimeve studentore që synojnë përfshirjen dhe angazhimin e studentëve, përfshirja e mendimit të studentëve është e garantuar.</p> <p>Për realizimin e programit mësimor, studentëve ju garantohet jo vetëm mbështetja dhe përdorimi i burimeve të logjistikës së nevojshme të vete institucionit, por edhe të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p> <p>Evidenca 12: Rregullore e zyrës, njësisë së këshillimit dhe karrierës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni parashikon</p>	<p>Institucioni nëpërmjet Zyrës së Financës nën drejtimin e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


Faqe 40

<p>koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>	<p>Administratorit të Deleguar, hartojnë çdo vit raportet me të dhëna të hollësishme, financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si dhe të veprimtarive që lidhen me kërkimin shkencor dhe kualifikimin e personelit dhe mbi bazën e tyre bëhen parashikime për periudha afatmesme, e afatgjata. Në material janë paraqitur tabela me të dhëna financiare sipas viteve p.sh:</p> <p>Për vitin 2018 ka një kapacitet financiar 257.972.813 gjithsej.</p> <p>Për vitin 2019 ka nje kapacitet financiar 236.774.248. gjithsej.</p> <p>Për vitin 2020 ka nje kapacitet financiar 235.351.504. gjithsej.</p> <p>Plani Financiar ka raport vjetor me të dhëna të plota mbi financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet financiare operative, detyrimet financiare, grantet të cilat likuidohen me korrektësi etj.</p> <p>Evidenca 49: Raporti financiar vjetor UniBa.</p> <p>Evidenca 50: Të dhëna nga plani i financimit të programit.</p> <p>Evidenca 50a: Burimet Financiare të UniBa.</p>			
<p>Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative; të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.</p>	<p>Pasqyrat financiare ndër vite, raportet e auditimit, opinionet dhe sugjerimet e Bordit, rezultojnë se Institucioni ka qëndrueshmëri financiare dhe kapacitetet financiare të duhura për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. Raporti i auditimit financiar evidenton përdorimin e të ardhurave nga tarifat e studentëve konsulta, shërbime, trainime nga donatorë të ndryshëm, konferencat që zhvillohen dhe shërbime të tjera në favor të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve për studentët, prurjet e të cilëve janë të mjaftueshme.</p> <p>Evidenca 49: Raporti financiar vjetor UniBa.</p> <p>Evidenca 50: Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit.</p> <p>Evidenca 50a: Burimet Financiare UniBa.</p> <p>Evidenca 50b: Raport i audituesve të pavarur dhe pasqyrat.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 41

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kritere të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin e studentëve nga hyrja në dalje deri në mbarimin e plotë të ciklit akademik në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 si dhe VKM nr. 41. dt. 24.01.2018 i ndryshuar me VKM nr. 879, dt. 18.12.2019, në statutin dhe rregulloren akademike të Universitetit "Barleti", institucioni ka hartuar dhe zbaton rregulloren e programit të studimit "Operator në Fitnes Palestra dhe Eventesh Publike". Institucioni kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit, në hyrjet daljet nga mësimi, realizimi i provimeve sipas kërkesave, dhe çdo veprimtari të tyre për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Universiteti Barleti ka një strukturë të mirëorganizuar për shërbimet studentore nga hyrja në dalje që drejtohen nga Zv. Rektori për Çështjet Studentore i cili drejton punën e disa zyrave si:</p> <p>Zyra e Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit,</p> <p>Zyra e Dekanit, Portali i Studentëve dhe qeveria studentore,</p> <p>Zyra e Alumnit dhe Karrierës.</p> <p>Sekretaria mësimore</p> <p>Detyrat dhe përgjegjësitë e secilës prej zyrave përshkruhen në rregulloren e UniBa.</p> <p>Evidenca 2: Statuti i Universitetit Barleti;</p> <p>Evidenca 7 Rregullore e programit të studimit "Operator në Fitnes Palestra dhe Eventesh Publike"</p> <p>Evidenca 53: Ligji i Arsimit te Lartë.</p> <p>Evidenca 55.1: Vkm Nr.41 dt.24.01.18</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit, të përzgjedhjes së studentëve bëhen me paraqitjen e dokumenteve personale sipas kërkesave të pranimit duke ndjekur hap pas hapi të gjitha fazat deri në regjistrim, proces i cili kalon në tre raunde të percaktuara nga MASK. Pasi shpallet lista e fituesve për programin përkatës studentët vihen në dijeni dhe për afatin përfundimtar të regjistrimit. Informacioni reklamohet në ambientet e universitetit</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423




Web site: www.ascal.al

Faqe 42

me to.	<p>dhe gjëndet dhe në rrjetin online, ndërsa për transferimet, studentët bëjnë kërkesë dhe procedurat janë lehtësisht të aksesueshme, transparente dhe publike. Çdo i interesuar mund t'i aksesojë ato si faqen zyrtare të internetit të Universitetit si edhe nëpërmjet, komunikimeve direkte në zyrat përkatëse të institucionit si në sekretari ose në departamentin përkatës. Vihet re një prurje e vogël në këtë program me një numër total 22 studentë.</p> <p>Evidenca 65: Manual-Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimet të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar procedurat dhe informacioni i detajuar lidhur me të gjithë procesin dhe përparimin akademik të studentëve. Në rregullore parashikohen të drejtat dhe detyrat e studentëve, dokumentimi i vlerësimeve me procese të notave, komunikimi dhe mënyra e vlerësimeve, përfshin vlerësimin e vazhduar dhe vlerësimin në provim, e drejta për të hyrë në provim, kriteret dhe procedura të transferimit të studimeve, ndërprerja dhe rifillimi i studimeve, kohëzgjatja e studimit të programit e cila është dy vjeçare me 120 ECTS, me 60 ECTS në vit dhe 30 ECTS në semester, me Diplomë Profesionale në “Operator në Fitnes Palestra dhe Eventes Publike” e Nivelit të 5 sipas KSHK. Përmes koordinatorës së departamentit dhe sekretarisë mësimore, studentët informohen në detaje lidhur me secilën prej procedurave të parashikuara.</p> <p>Ata ofrojnë informacion për vlerësimet për secilën lëndë të zhvilluar gjatë gjithë vitit akademik, për numrin e krediteve të akumuluar për të kaluar nga një vit akademik në tjetrin, që është jo më pak se 30 kredite. Në rastet kur ka pakënaqësi për vlerësimin, studenti duhet të ballafaqohet me pedagogun, në rast mosbindje vazhdon rrugën mëtej, ku bëhet ngritja e komisionit, marrja në provim dhe vlerësimi i dalë është dhe vlerësimi përfundimtar. Studentët sqarohen për frekuentimin, për realizimin e praktikës profesionale. Në javën e parë të pranimit në UniBa, gjatë javës së akomodimit, studentët njihen me të gjithë dokumentacionin zyrtar, ambjentet dhe shërbimet në funksion të tyre.</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e Programit “Operator në Fitnes Palestra dhe Evente Publike ”</p> <p>Evidenca 72: Për llogaritjen e krediteve dhe shpërndarjen e Lëndëve dhe moduleve mesimore në SHLUIJ UMBJ.</p>
<p>Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar procedurat dhe informacioni i detajuar lidhur me të gjithë procesin dhe përparimin akademik të studentëve. Struktura e programit është kohëzgjatja dy vjeçare me 120 ECTS me 60</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423




Web site: www.ascal.al

Faqe 43

<p>dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>ECTS në vit dhe 30 ECTS në semestër. Për kalimin nga një vit në vitin tjetër duhet të paktën të fitohen 30 ECTS.</p> <p>Përmes koordinatores së departamentit dhe sekretarisë mësimore, studentet informohen në detaje lidhur me secilën prej procedurave të parashikuara. Ata ofrojnë informacion për vlerësimet për secilën lëndë të zhvilluar gjatë gjithë vitit akademik për numrin e krediteve të akumuluar etj. Orientimin drejt tregut të punës e realizojnë në bashkëpunim me Zyrën e Alumnit dhe Karrierës me klubet studentore etj. Në javën e parë të pranimit në UniBa, gjatë javës së akomodimit, studentët njihen me të gjithë dokumentacionin zyrtar, ambientet dhe shërbimet në funksion të tyre.</p> <p>Evidenca 7 Rregullore e Programit “Operator në Fitnes Palestra dhe Evente Publike ”</p> <p>Evidenca 72: Per llogaritjen e krediteve dhe shperndarjes se Iendeve dhe moduleve mesimore ne SHLUJ UMBJ</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Informacioni i studentëve për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese jepet nga sekretaria nga Departamenti përkatës dhe në syllabusin e lëndës nga pedagogu/ia e lëndës në çdo fillim viti e fillim simestri. Pedagogu informon studentin për të gjitha detajet e lëndës ose të modulit, si emertesën e lëndës, kreditet ngarkesën e orëve leksionet dhe seminarët, llojin e vlerësimit me provim apo firmë. Studenti informohet me gojë për rezultatin e arritur në provim. Studentët marrin dhe informacion të gjerë e të përditësuar nëpërmjet rrjeteve elektronike, emaile etj.</p>			
<p>Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Informacioni i detajuar në lidhje me programin e studimit, lëndët përbërëse të tij, sipas viteve dhe semestrave, krediteve javëve mësimore për semester etj mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe është i publikuar në faqen e internetit të UniBa dhe i cili është lehtësisht i menaxhueshëm nga studentët edhe në distancë. Në fillim të çdo semestri studentët njihen me të gjithë programet lëndore (syllabuset), ku jepen në detaje temat e lëndës, kreditet, ngarkesa forma e kontrollit të dijeve, literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar. Së fundmi, me kalimin e procesit mësimor online ky informacion është edhe pjesë e platformës google-classroom, ku çdo student sheh gjithë materialet sipas javëve dhe temave përkatëse.</p> <p>Evidenca 13.1 Manual i mësimdhënies online.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423




Web site: www.ascal.al

Faqe 44

Standardi IV.5


Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës. Sekretaria Mësimore dhe Zyra e " Alumnit dhe Karrieres" disponojnë të dhëna të sakta në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar në çdo vit akademik në amzë dhe të gjitha të dhënat e tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënien në programin e studimit "Operator në Fitnes Palestra dhe Eventesh Publike "</p> <p><u>Ja disa të dhëna nga viti 2018 deri 2022:</u></p> <p>Në vitin 2018/2020 janë 14 të regjistruar. Nota Mesatare 5.67 në hyrje.</p> <p>Në vitin 2019/2021 janë 8 të regjistruar. Nota Mesatare.5.96 në hyrje.</p> <p>Nota mesatare në dalje është në proces.</p> <p>Të diplomuar janë 1 (një) në total.</p> <p>Të punësuar nuk ka.</p> <p><i>Evidenca 27: Te dhena te plota per regjistrimin, ecurine, diplomimin e studenteve, sipas viteve akademike, nota mesatare ne hyrje dhe ne dalje.</i></p> <p><i>Evidenca 13.1 Manual i mesimdhënies online.</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>I gjithë dokumentacioni i nevojshëm është i aksesueshem, i kategorizuar sipas njësive të ndryshme. Gjithashtu, sistemi për komunikimin e brendshëm përfshin komunikimin online me platformat e vëna në dispozicion si edhe me anë të intranetit të monitoruar nën domain të universitetit dhe komunikimi me publikun nëpërmjet site zyrtar, mediave sociale, etj. Në këto sisteme gjendet çdo informacion në lidhje me programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca 46: Udhezues per perdorimin e struktures se teknologjise se informacionit</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar i cili garantohet nëpërmjet logimit me kredencialet personale, në</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al

Faqe 45

informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	platformat online, sipas kategorisë së përdoruesit. <i>Evidenca46: Udhëzues për përdorimin e Strukturaes se Teknologjise se informacionit</i>			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Në dy vitet e fundit 2019/2021 aktiviteti mësimor dhe komunikimi, është transferuar gradualisht në google classroom ku studentët mund të gjejnë informacione edhe më të detajuara për lëndët e modulet, materialet mësimore, syllabusin e lëndës, vlerësimet materiale shitesë etj. Platforma e google classroom ka ndihmuar në zhvillimin e mësimin online. Gjithashtu përdorimi i adresave zyrtare të e-mailit, si për stafin ashtu edhe për studentët, vijon të mbetet një ndër format kryesore të komunikimit. <i>Evidenca 46: Udhëzues për përdorimin e Strukturaes se Teknologjise se informacionit.</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Përdorimi i sistemeve të ndryshme elektronike garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, duke mundësuar raportimin dhe të dhënat për organet drejtuese dhe titullarët, në kohë reale, për informacione të ndryshme, në mënyrë të shpejtë dhe të saktë. <u>Në universitet është vendosur chek-in dhe chek-out si një formë e re e angazhimit në kohë të stafit, por që në një farë mënyre prek lirinë akademike të stafit.</u> <i>Evidenca 46: Udhëzues për përdorimin e Strukturaes se Teknologjise se Informacionit</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	UniBa publikon on-line të dhënat e nevojshme në lidhje me programet, ofertën akademike, strukturën, sezonin e provimeve dhe riprovimeve dhe funksionimin e Institucionit, si dhe dokumentacionin ligjor të tij. Informacionet publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. Promovimi i UniBa bëhet me moton “Eja në Barlet” “Ndërto të ardhmen tënde”			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423


Web site: www.ascal.al

Faqe 46

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al

Faqe 47

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin e studentëve nga hyrja në dalje deri në mbarimin e plotë të ciklit akademik në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 si dhe VKM nr. 41 dt. 24.01.2018 i ndryshuar me VKM nr. 879, dt. 18.12.2019, në Statutin dhe rregulloren akademike të Universitetit "Barleti", institucioni ka hartuar dhe zbaton rregulloren e programit të studimit "Operator në Fitnes Palestra dhe Eventesh Publike". Institucioni kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit, në hyrjet daljet nga mësimi, realizimi i provimeve sipas kërkesave etj.</p> <p>Ka një strukturë të mirë organizuar për shërbimet studentore nga hyrja në dalje që drejtohen nga Zv. Rektori i cili drejton punën e disa zyrave si: Zyra e Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit, zyra e Dekanit, Portali i Studentëve dhe qeveria studentore, Zyrën e Alumnit dhe Karrierës. Detyrat dhe përgjegjësitë e secilës prej zyrave përshkruhen në rregulloren e UniBa. Kriteret, procedurat e pranimit, të përzgjedhjes së studentëve bëhen me paraqitjen e dokumenteve personale sipas kërkesave të pranimit. Pasi shpallet lista e fituesve për programin përkatës studentët vihen në dijeni dhe për afatin perfundimtar të regjistrimit. Ndërsa për transferimet studentët bëjnë kërkesë dhe procedurat janë lehtësisht të aksesueshme, transparente dhe publike. Çdo i interesuar mund t'i aksesojë ato si në faqen zyrtare të internetit të Universitetit si edhe nëpërmjet, komunikimeve direkte në zyrat përkatëse të institucionit si në sekretari ose në departamentin përkatës dhe në aktet rregullatore të UniBa.</p> <p><i>Evidenca 2: Statuti i Universitetit Barleti</i></p> <p><i>Evidenca 7 Rregullore e programit të studimit "Operator në Fitnes Palestra dhe Eventesh Publike"</i></p> <p><i>Evidenca 53: Ligji i Arsimit të Lartë;</i></p> <p><i>Evidenca 55.1: VKM Nr.41 dt.24.01.18.</i></p> <p><i>Evidenca 65:Manual -Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin</p>	<p>Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje janë transparente për të gjithë, duke garantuar barazi dhe të drejta të barabarta për</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


Faqe 48

<p>drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>kandidatët dhe studentët e programeve të studimit. Kjo përbën dhe një nga parimet e funksionit të UniBa, përshkruar në rregulloren e institucionit, rregulloren e programit, manualin e bursave e të gjitha aktet e tjera rregullatore të UniBa. Përsa i përket orientimit drejt tregut të punës merren instancat e ngritura siç janë:</p> <p>Zyra e Dekanit, Portali i Studentëve dhe qeveria studentore, Zyra e Alumnit dhe Karrierës.</p> <p>Të gjitha të dhënat janë të pasqyruara dhe në rrjetet elektronike.</p> <p>Evidenca 2 Statuti i Universitetit Barleti;</p> <p>Evidenca 5 Rregullore e Universiteti Barleti;</p> <p>Evidenca 7 Rregullore e Programit “Operator ne Fitnes Palestra dhe Eventesh Publike”</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit, të përzgjedhjes së studentëve bëhen me paraqitjen e dokumenteve personale sipas kërkesave të pranimit, të përgjithshme dhe të veçanta. Pranë sekretarisë mësimore bëhet shikimi i dokumentave dhe shpallet lista e fituesve për programin përkates. Studentët vihen në dijeni për afatin e fillimit dhe të përfundimit të regjistrimit. Ndërsa për transferimet studentët bëjnë kërkesë dhe procedurat janë lehtësisht të aksesueshme, transparente dhe publike. Çdo i interesuar mund t'i aksesojë ato si në faqen zyrtare të internetit të Universitetit si edhe nëpërmjet, komunikimeve direkte në zyrat përkatëse të institucionit si në sekretari ose në departamentin përkatës. Vihet re një prurje e vogël studentësh, ndoshta për faktin që është program i ri megjithëse me vitin akademik 2021/2022 është duke përfunduar ciklin e dytë të plotë të programit. Kjo tregon që duhet një punë më e madhe promovuese.</p> <p>Evidenca 65: Manual- Rekrutim- Aplikim- Regjistrim- Transferim.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar procedurat dhe informacioni i detajuar lidhur me të gjithë procesin dhe përparimin akademik të studentëve. Në rregullore parashikohen të drejtat dhe detyrat e studentëve, dokumentimi i vlerësimeve me procese të notave që gjenden në sekretarinë mësimore. Komunikimi dhe mënyra e vlerësimeve e cila bëhet nga pedagogu i lëndës në fillim të çdo semestri, përfshin vlerësimin e vazhduar dhe vlerësimin në provim. Provimi mund të jetë me shkrim, me shkrim dhe me gojë e përcaktohet nga pedagogu. E drejta për të hyrë në provim është kur studenti të ketë frekuentuar në rregull sipas rregullores që ka institucioni.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al


Faqe 49

	<p>Kriteret dhe procedurat e rivleresimit, transferimi i studimeve, ndërprerja dhe rifillimi i studimeve kohëzgjatja e studimit të programit e cila është dy vjeçare me 120 ECTS, 60 ECTS në vit dhe 30 ECTS në semester janë të njohura për studentët.</p> <p>Për të kaluar nga një vit në tjetrin studenti duhet të paktën të sigurojë 30 kredite. Përmes koordinatores së departamentit dhe sekretarisë mesimore, studentët informohen në detaje lidhur me secilën prej procedurave të parashikuara. Ata ofrojnë informacion për vlerësimet për secilën lëndë të zhvilluar gjatë gjithë vitit akademik për numrin e krediteve të akumuluar etj. Në javën e parë të pranimit në UniBa, gjatë javës së akomodimit, studentët njihen me të gjithë dokumentacionin zyrtar ambjentet dhe shërbimet në funksion të tyre.</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e Programit “Operator ne Fitnes Palestra dhe Eventesh Publike”</p> <p>Evidenca 72: Per llogaritjen e krediteve dhe shperndarjes se lendeve dhe moduleve mesimore ne SHLUJ UMBJ</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit “Operator në Fitnes Palestra dhe Evente Publike” materialet që studenti duhet të njihet që në fillim të vitit akademik ku janë parashikuar edhe procedura të vlerësimit, e drejta për të hyrë në provim, zhvillimi i provimeve, komunikimi i vlerësimeve dhe dokumentimi i vlerësimeve. Format e vlerësimit të dijeve janë parashikuar edhe në syllabusin e lëndës dhe paraqiten nga pedagogu/ia e lëndës tek studentët në çdo fillim viti e fillim semestri. Pedagogu informon studentin me gojë për rezultatin e arritur brenda shtatë ditëve. Në rast mosbindje për notën studenti vazhdon procedurat e përmirësimit të notës sipas rregullores. Bëhet kërkesë/ ankesë pranë departamentit i cili ngre komisionin e pedagogëve që do ta marrin në provim ku vlerësimi me notë është perfundimtar. Për marrjen e diplomës studenti duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet. Evidenca 7: Rregullore e Programit</p>
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>UniBa zbaton një politikë promovuese për informimin e të interesuarve për programin e studimit “Operator në Fitnes Palestra dhe Evente Publike”. Në këtë plan përfshihen konferenca me maturantët, konferenca me mësuesit e karrierës, workshop-e dhe jo vetëm, por edhe vizita të maturantëve në ambjentet e UniBa ku pedagogë dhe përfaqësues të departamenteve kanë prezantuar detajet nga secili program studimi, konkurse me ese, etj. Po ashtu, në fillim të vitit të ri akademik, UniBa zhvillon Javen e Orientimit, ku studentët prezantohen me ambjentet, stafin akademik të programit të studimit dhe atë mbështetës. <u>Por, promovimi duhet të mbërrijë në të gjitha palestrat sportive nëqoftese është e mundur për ti ndjekur, në mënyrë që ndikimi</u></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 50



	dhe tërheqja për në universitet të jetë më e madhe. Dy vitet e fundit, në kushtet e diktuar nga pandemia, Covid 19 UniBa është përshtatur duke realizuar një pjesë të aktiviteteve të rekrutimit dhe informimit online. <i>Evidenca 14.1, 14.2: Kurrikula e Programit “Operator ne Fitnes Palestra dhe Eventesh Publike”</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.	<p>Informimi në mënyrë të detajuar i studentëve për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit bëhet në disa forma të ndryshme: Ditët e para të pritjes me maturantët organizohen takime informuese, sqaruese dhe orientuese në lidhje me programin e studimit “Operator në Fitnes Palestra dhe Eventesh Publike” Gjatë periudhës së regjistrimit dhe gjatë javës së parë të akomodimit, Dekani i Fakultetit apo përgjegjësi i Departamentit dhe personeli akademik bëjnë prezantimin e programit të studimit, i cili përbëhet nga lëndët bazë, lëndët karakterizuese, lëndët ndërdisiplinore, lëndët plotësuese dhe detyrimet përmbyllëse, të shoqëruara me përqindjet përkatëse për çdo grup. Në program pasqyrohen kreditet në total 120 ECTS, për viti 60 ECTS dhe për semestrër 30 ECTS. Janë orët e lëndëve të përcaktuara në leksione, seminare, praktika, laboratore dhe provimet.</p> <p>Gjatë studimeve pedagogu koordinator i departamentit, bën orientime në lidhje me organizimin e programit të studimit. Për ti shërbyer procesit të informimit janë përgatitur dhe vënë në dispozicion në hollin e institucionit materiale informuese, sqaruese dhe ndërgjegjësuese si: fletëpalosje, postera, broshura etj, si dhe materiale audio-vizive si: spote televizive, mesazhe promovionale, etj. Të dhëna të detajuara për programin e studimit gjënden edhe në faqen e internetit, në hapësirën virtuale dedikuar këtij departamenti. Nëpërmjet rrjetit të gjërë të shërbimeve studentore studentët kanë një jetë aktive në UniBa ku ndërthuren projektet dhe aktivitetet e iniciuara</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


Faqe 51

	nga pedagogët, departamentet me aktivitete të inciuara nga studentët nëpërmjet klubeve studentore dhe aktiviteteve të tjera. Evidenca Manual i Programit te Studimit.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Praktika është pjesë e programit mësimor e pasqyruar dhe me orët e saj në semester në programin e studimit. Departamenti i Edukimit Fizik, Koordinator i saj, informojnë studentët me të gjithë procedurën e planifikimit dhe të realizimit të praktikës. Departamenti përcakton pedagogun përgjegjës që ndjek grupet e studentëve të praktikës dhe bashkëpunon me mësuesin e shkollës partnere. Institucioni ka kontrata bashkëpunimi me shkollat e mesme dhe 9 vjeçare në të gjithë Shqipërinë, me ambiente të ndryshme sportive ku dhe bëhet shpërndarja e studentëve në grupe praktike. Ky bashkëveprim lehtëson angazhimin dhe ndërveprimin e studentëve me punëdhënësit e ardhshëm si BTTC dhe AM Barleti Human Capital. Dy vitet e fundit, në kushtet e diktuar nga pandemia, Covid 19 UniBa është përshtatur me situatën duke realizuar praktikën në mënyrë të kufizuar brenda ambientit të universitetit me grupe studentësh. Evidenca Rregullore e Universitetit Barleti, Shtyllat e aktiviteteve kryesore ne UniBa.
Kriteri 3. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në funksion të realizimit të procesit mësimor studentëve u vihet në dispozicion nga Koordinator i Departamentit, Sekretaria Mësimore, por edhe Dekani i Studentëve jep informacion të gjerë dhe të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet. Veçanërisht, Koordinator i Departamentit dhe Sekretaria Mësimore mbajnë kontakte të rregullta me studentët që ndjekin programin e studimit “Operator në Fitnes Palestra dhe Eventesh Publike” nëpërmjet komunikimeve elektronike dhe portalit studentor. Çdo ndryshim në orar, ose ndryshim gjatë zbatimit të tij, u njoftohet studentëve nëpërmjet email-it zyrtar nga sekretaria në lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në UniBa. Informacioni u dërgohet dhe nga Koordinator i Departamentit dhe Dekani i Studentëve ose përgjegjësi i departamentit. Evidenca 36: Detyrat e Koordinatorit.
Kriteri 4. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacion i detajuar në lidhje me programin e studimit, lëndët përbërëse të tij, sipas viteve dhe semestrave, krediteve javëve mësimore për semester etj, mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe është i publikuar në faqen e internetit të UniBa dhe i cili është lehtësisht i menaxhueshëm nga studentët edhe në distancë. Në fillim të çdo semestri studentët njihen me të gjitha programet lëndore (syllabuset), ku jepen në detaje temat e lëndës, literatura

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 52


	<p>kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar, forma e shlyerjes së lëndës si me provim apo firmë. Së fundmi, me kalimin e procesit mësimor online ky informacion tashmë është edhe pjesë e platformës google-classroom, ku çdo student sheh gjithë materialet sipas javëve dhe temave përkatëse.</p> <p><i>Evidenca 13.1 Manual i mësimdhënies online.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
<p>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vite. Në këtë program ka mbaruar një cikël i plotë dy vjeçar dhe në 2022 mbaron ciklin e dytë, por numri i të diplomuarve është vetëm 1 (një).</p> <p><i>Evidenca 27: Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Institucioni disponon një bazë të dhënash të detajuara në lidhje me studentët e regjistruar në programin e studimit, studentët e transferuar:</p> <p>Për 2018/2020 kemi 14 studentë të regjistruar.</p> <p>Për 2019/2021 kemi 8 studentë të regjistruar</p> <p>Në total kemi 22 studentë.</p> <p>Për studentë që kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër ose që janë të çregjistruar nuk ka informacion.</p> <p>Kjo tregon se nuk ka promovim shumë efikas për programin.</p> <p><i>Evidenca : Të dhëna tabelore përmbledhëse për transferimet e studimeve nga studentët.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve</p>	<p>Departamenti dhe institucioni disponon të dhëna të plota për çdo student për ecurinë e studimeve që nga momenti i regjistrimit deri në diplomimin e tij. Të dhënat gjenden në Sekretarinë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


Faqe 53

<p>që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.</p>	<p>Mësimore të Institucionit të regjistruara në regjistrin e të dhënave akademike, në amzë me numër matrikullimi të rregullt për secilin student dhe në formë elektronike.</p> <p><i>Evidenca: Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe dalje.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat e studentëve menaxhohen nga Sekretaria mësimore nëpërmjet përdorimit të sistemit të brendshëm të informacionit për të dhënat. Gjithashtu në funksion të studentëve është edhe portali studentor, platformë ku studenti merr çdo lloj informacioni në lidhje me aktivitetin e tyre në përgjithësi. Këtu gjenden të hedhura të dhënat mbi: notat dhe rezultatet e provimeve, data e zhvillimit të provimit, kreditet e fituara etj. Portali studentor u mundëson atyre të informohen në kohë reale lidhur me rezultatet e tyre akademike dhe të dhëna të tjera me rëndësi për ta. Sekretaria mësimore përpunon këto të dhëna për Dekanin dhe Përgjegjësin e Departamentit sipas kërkesës. Studentët janë të kënaqur me shërbimin që u ofrohet. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> <p><i>Evidenca 48c: Portali studentor.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Institucioni realizon për çdo vit akademik një raport analitik kryesisht me shifra, ku prezanton cilesinë e studentëve, rezultatet e arritura prej tyre, si dhe realizimin e objektivave të departamentit për këtë program studimi. Raportet kryesisht trajtohen në departament me tematika të veçanta, si për frekuentimin, për praktikën etj. Ky informacion përdoret për të bërë analizën vjetore të departamentit dhe të institucionit dhe paraqitet në raportin vjetor. Këto të dhëna janë pjesë të punës së njëjësive bazë për ecurinë e programeve të studimit dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e këtyre treguesve. Departamenti në bashkëpunim me zyrën e Alumnit ruajnë komunikime të shpeshta me të diplomuarit e tyre lidhur me ecurinë e tyre në tregun e punës dhe mbështesin ata në mënyrë të mëtejshme nëpërmjet kualifikimit të vazhduar.</p> <p><i>Evidenca 38: Analizë e Departamentit përgjegjës mbi arritjet e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423



Standardi V.4


Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Në statutin dhe në Rregulloren e Universitetit "Barleti", parashikohet përfshirja dhe angazhimi i studentëve në organe vendimmarrëse si dhe inkurajimi i pjesëmarrjes së studentëve në vendimmarrje, organizimin e lirë dhe shprehjen e mendimit të tyre. Ndër strukturat kryesore të përfshirjes së studentëve përmendim:</p> <p>Senatin Akademik;</p> <p>Këshillin e Etikës dhe Shanseve të Barabarta ;</p> <p>Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë;</p> <p>Dekanatin e Fakultetit;</p> <p>Këshillin/qeverinë e studentëve;</p> <p>Mbledhjet e departamenteve, një herë në muaj të hapura për studentët.</p> <p>Grupin e vlerësimit të brendshëm.</p> <p><i>Evidencë 2: Statuti i Universitetit Barleti</i></p> <p><i>Evidencë 5: Rregullore e Universitetit Barleti</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Studentët të cilët janë të përfshirë në organet vendimmarrëse të UniBa janë pjesë e pandarë e strukturave ku ata bëjnë pjesë. Si anëtarë të këtyre organeve ata njoftohen të marrin pjesë. Mendimet e tyre, problematikat e tyre janë pjesë e diskutimeve në këto organe. Studentët përfshihen në forma dhe mënyra të ndryshme në vlerësimin e procesit akademik. Sondazhi që organizohet nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë bëhet, dy herë në vit e mbledh të dhëna për secilën lëndë dhe secilin pedagog dhe të gjithë studentët mund të japin mendimet e tyre lidhur me proceset.</p> <p>Pyetëtori ka patur 22 pyetje për vitin 2020/2022 për programin "Operator në Fitnes Palestra dhe Eventesh Publike" i cili nuk rezulton pozitiv. Testimi është bërë nga janari në shkurt 2022. Numri i studentëve pjesëmarrës është 11 dhe reagimi i tyre është me 6 përgjigje. Gjithashtu, kjo njësi ka parashikuar edhe zhvillimin e fokus grupeve me studentet, megjithëse janë akoma jofunksionale, apo edhe sondazhe të tjera për të mbledhur</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 55

	<p>dhe vlerësuar opinionet e tyre.</p> <p>Një tjetër formë është dhe ajo e përfaqësimit me një anëtar student në GVB, grupet e punës të vlerësimit të brendshëm të akreditimeve të programeve apo akreditimit institucional. Studentet kanë një përfaqësues dhe në mbledhjet e departamentit.</p> <p>Evidence 68: Përbërja e GVB.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Sipas rregullore së Programit të studimit në mënyrë të vazhdueshme mbahet parasysh ngarkesa akademike e studentëve në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Shperndarja e lëndëve dhe provimeve nëpër semestra të jetë afërsisht e ballancuar. Ngarkesa e shprehur në kredite bëhet mbi parimin e jo më shumë se 30 kredite në semester dhe jo më shumë se 25 orë në javë. (në planin mesimor janë të programuara 20 orë në javë rregullorja e programit thotë se që studenti të kalojë në vitin pasardhës duhet të ketë të paktën 50% të krediteve ose 30 ECTS. Marrja e Diplomës me karakter profesional duhet të jetë me provim formimi. Studentët janë të njohur me procedurat e njohjes dhe ekuivalentimit të studimeve të plota apo të pjesshme të kryera më parë dhe asistohen nga njësitë e shërbimeve studentore dhe departamenti gjatë procesit. Procedurat janë të parashikuara në Manualin Rekrutim - Aplikim -Rregjistrim - Transferim i studentëve.</p> <p>Evidenca 65: Manualin Rekrutim, Aplikim Rregjistrim, Transferim.</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit realizohet përmes pyetësorëve të studenteve. Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilesisë, organizon anketime çdo semester, dy javë përpara mbarimit të tij, çdo vit me secilin grup për të gjitha programet e studimit, për të gjitha lëndët dhe pedagogët, të cilët i shërbejnë cilësisë së mësimdhënies. Nga të dhënat e mbledhura nga anketimi me studentët dalin me email sugjerimet për përmirësimin e programit të studimit. Studentët njoftohen për rezultatet e vlerësimeve të tyre për çështje të përmirësimin të kurrikulave dhe të mësimdhënies.</p> <p>Rezultatet e pyetësorëve përdoren nga njësia dhe pedagogët përkatës për të rishikuar lëndën dhe për të përmirësuar mësimdhënien dhe të nxënë. Bazuar në këto vlerësime janë bërë ndryshime në kurrikula dhe përmirësime të niveleve të shërbimit. Të gjitha evidencat pasqyrohen në një raport i cili shërben dhe si dokument për punën e GVB kjo e pasqyruar në</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423




Web site: www.ascal.al

Faqe 56

	<p>tabela.</p> <p><i>Evidenca 52: Manuali i hartimit te programeve te studimit dhe ndryshimit te programeve ekzistuese;</i></p> <p><i>Evidenca 13: Rregullore e zyres se monitorimit te kurrikules;</i></p> <p><i>Evidenca 8: Rregullore Njesise se Zhvillimit te Kurrikulave dhe Cilesise.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit / njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Kontrolli dhe vlerësimi i dijeve është një proces transparent, i cili shprehet në rregulloret e UNIBA, sikurse dhe në syllabusin e secilës lëndë. Dhënia e argumenteve për vlerësimin e studentëve nga pedagogu i secilës lëndë, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm, janë tregues i vëmendjes që ka UniBa ndaj transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Nga opinionet e studentëve rastet e ankimimit janë shumë të rralla.</p> <p><i>Evidenca 5: Rregullore e Universitetit Barleti, Neni 88.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.5

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Zyrat e posaçme të ngritura në UniBa me qëllim informimin dhe shërbimin ndaj studentëve janë:</p> <p>Zyra e Pranimi, Aplikim, Regjistrim, Transferim</p> <p>Sekretaria Mësimore,</p> <p>Dekani i Studentëve,</p> <p>Zyra e "Alumni dhe Karrierës" dhe Koordinatori i Departamentit.</p> <p>Klubi studentor</p> <p>Portali studentor.</p> <p>Këto zyra ndjekin ecurinë e studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar keshillim për çështje akademike, në shërbim të procesit mësimor, si dhe ato</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al



Faqe 57

	<p>studentor. Studentët janë të afektuar pozitivisht me shërbimet që ofrojnë keto zyra.</p> <p>Evidenca 9: Rregullore për Funkionimin e Sekretarisë Mësimore;</p> <p>Evidenca 12: Rregullore e Funkionimit të Zyrave në Shërbim të Studentëve pranë UNIBA</p>
<p>Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Studentët marrin informacion në mënyrë të drejtepërdrejtë, por dhe nga interneti, në burime të ndryshme. Studentët në UniBa mund t'i drejtohen Sekretarisë Mësimore dhe Koordinatorit të Departamentit për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> <p>Ata mund t'i drejtohen Dekanit të Studentëve dhe Zyrës së Alumnit dhe Karrierës, për të marrë informacion dhe këshillim për aktivitete e shërbime mbështetëse brenda dhe jashtë UniBa për mbarëvajtjen e jetës së tyre studentore.</p>
<p>Kriteri 3. Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Studentit në UniBa i ofrohet informacion për karrierën duke ju drejtuar zyrës së Alumnit dhe Karrierës. Dekani i Studentëve dhe Zyra e Alumnit dhe Karrierës, në bashkëpunim të vazhdueshëm me departamentet, lehtësojnë të gjithë studentët për shërbimin e këshillimit të karrierës. Në këtë drejtim duhet të punohet më shumë që studentët që mbarojnë të jenë konkretisht më shumë të informuar dhe më afër tregut të punës. Gjithashtu studentët orientohen për institucionet ku mund të zhvillojnë praktikën e tyre profesionale, nëpërmjet koordinatorit të departamentit dhe pedagogut të përcaktuar për të mbikqyrur lëndën e praktikës profesionale të parashikuar në planin mësimor të këtij programi studimi.</p> <p>Për vitin 2019/2021 praktikat profesionale për shkak të Covidit 19 janë zhvilluar në ambjentet e universitetit brenda përbrenda grupit. Klubi i Karrierës organizon një seri aktivitetsesh në dobi dhe në ndihmë të studentëve, me fokus zhvillimin dhe rehabilitimin e aftësive individuale dhe profesionale të tyre, për t'u bërë konkures në tregun e punës. Klubet janë të organizuara në fusha të ndryshme përfshi dhe sportin. Grupi Barleti ka një rrjet të gjerë strukturash të fokusuara në kërkim shkencor dhe në aktivitete që lehtësojnë angazhimin dhe ndërveprimin e studentëve me punëdhënësit e ardhshëm si BTTC dhe AM-Barletian Human Capital.</p> <p>Evidenca 12: Rregullore e Funkionimit të Zyrave në Shërbim të Studentëve pranë UniBa.</p> <p>Evidenca 5: Rregullore e Universitetit “ Barleti”</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek</p>	<p>Numri i të Diplomuarve dhe i të punësuarve për programin e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 58


<p>studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	<p>studimit “Operator në Fitnes Palestra dhe Eventesh Publike” është vetëm 1 (një). Kjo tregon që është i nevojshëm studimi më i mirë i tregut të punës nga Zyra e Alumnit dhe Karrierës në UniBa e cila mban edhe të dhëna për punësimin. Mbatja në kontakte të vazhdueshme me ambiente të ndryshme si palestra, ambiente sportive për të patur informacionin e duhur në lidhje me nevojat e tyre dhe për të qenë më cilësor në atë çfarë ofrojnë. Këto të dhëna ajo i siguron bazuar në komunikimet e vazhdueshme me ta, nëpërmjet adresave të e-mailit, të dhënave të kontaktit, adresave të rrjeteve sociale, etj.</p> <p><i>Evidenca 12: Rregullore e Funkcionimit të Zyrave në Shërbim të Studentëve pranë UNIBA</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 59

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional “Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh publike” të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Barleti”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Staf i akademik i brëndshëm që mbulon programin, disponon gradat dhe titujt akademikë në përmbushje të detyrimeve ligjore;
2. Programi operon mbi një repertor të gjërë disiplinash që thellojnë dijen rreth fitnessit, aktivitetit fizik për shëndet dhe organizimin e eventeve publike dhe jo vetëm;
3. Marrëdhënie bashkëpunuese me tregun e punës me subjekte publike dhe jopublike, që janë të lidhura drejtpërdrejtë me fushën e programit të studimit e që i kontribuojnë cilësisë së praktikave profesionale të studentëve;
4. Zgjerimi i hapësirës infrastrukture (kampusi i ri) dhe paisja me teknologji moderne e bashkëkohore informacioni, ndikon drejtpërdrejt në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe kanë impakt të drejtpërdrejtë pozitiv në drejtim të arritjeve të objektivave të mësimdhënies e mësimnxënies të programit të studimit;

Pika të dobëta:

1. Një mospërputhje e theksuar e planit mësimor me Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë) (Ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019; nr. 185, datë 25.3.2021), pasaktësi në shpërndarjen e komponentëve mësimorë sipas përqindjeve të kategorive.
2. Mungesa e një studimi të mirëfillët të tregut të punës i cili është shumë i nevojshëm për një ecuri edhe më të suksesshme të këtij programi studimi. Departamenti të bëjë studime të vërteta të kërkesave të tregut të punës e mos të mbetet në opinione individuale siç rezulton në evidencat e paraqitura.
3. Nuk është përcaktuar detyrim përmbyllës. Programet profesionale të Kornizës së 5 të kualifikimeve përfundojnë me detyrim përmbyllës domosdoshmërisht.

Rekomandime:

1. Të ripunohet plani mësimor në përputhje të plotë me Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë) (Ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019; nr. 185, datë 25.3.2021).

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al


Tel: +355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al

Faqe 60

2. Pothuajse mungon referenca në literaturë shqipe, ndërkohë që programi është në nivel diplome profesionale dhe ka nevojë për literaturë në shqip sepse programi i studimit është me karakter profesional dhe dihet që studentët kanë një mesatare të ulët në hyrje.
3. Të mendohet seriozisht për një studim të mirëfilltë të tregut të punës dhe të evidentohet ecuria dhe punësimi i studentëve pas përfundimit të studimeve.
4. Është e nevojshme përfshirja e më shumë lëndëve/ moduleve që lidhen dhe i referohen direkt formimit të përgjithshëm në fitnes, palestra dhe evente publike pse jo edhe private.



Conclusions of the evaluation of the professional study program " Fitness, gym and public event operator " of the Institution of Higher Education "Barleti" University

Strengths and Affirmations:

1. The internal academic staff that covers the program, dispose of the degrees and academic titles in fulfillment of legal obligations;
2. The program operates on a wide repertoire of disciplines that deepen knowledge about fitness, physical activity for health and the organization of public events and more.
3. Collaborative relations with the labor market with public and non-public entities, which are directly related to the field of the study program and which contribute to the quality of students' professional practices;
4. The expansion of the infrastructural space (new campus) and the equipment with modern and contemporary information technology directly affects the progress of the teaching process and has a direct positive impact in terms of achieving the teaching and learning objectives of the study program;

Weak points:

1. A marked inconsistency of the curriculum with Decision No. 41, dated 24.1.2018 "On the elements of study programs offered by higher education institutions) (Amended by VKM no. 879, dated 18.12.2019; no. 185, dated 25.3.2021), inaccuracy in the distribution of components teaching according to percentages of categories.
2. The lack of a genuine study of the labor market, which is very necessary for an even more successful progress of this study program. The department should make real studies of the requirements of the labor market and not remain in individual opinions as it results in the presented evidence.
3. No final obligation has been defined. The professional programs of the 5th Framework of qualifications necessarily end with a final obligation.



Recommendations:

1. Rework the curriculum in full compliance with Decision No. 41, dated 24.1.2018 "On the elements of the study programs offered by higher education institutions) (Amended by VKM no. 879, dated 18.12.2019; no. 185, dated 25.3.2021).

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al

Page 62

2. There is almost no reference to Albanian literature, while the program is at the level of a professional diploma and there is a need for literature in Albanian because the study program is of a professional nature and it is known that the students have a low entrance average.
3. To think seriously about a genuine study of the labor market and to record the progress and employment of students after completing their studies.
4. It is necessary to include more subjects/ modules that are related and refer directly to general training in fitness, gyms and public events, if not private ones.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 64